



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave  
në “Administrim Biznesi”  
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**PhD. Endrit Kromidha**

**PhD. Eriona Shtëmbari**

**Mars, 2021**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për Programin e studimit: Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Ekonomike, (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 56, datë 21.01.2009 Urdhër UMASH nr 308, datë 08.06.2010 për lejimin e veprimtarisë akademike
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	UMASH Nr. 385, datë 06.09.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditimi periodik: VBA Nr. 80, datë 27.10.2018 (vlefshmëria e akreditimit: 30.09.2020; kohëzgjatja 2 vite akademike) (me rekomandime)
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik aktual <b>2020-2021</b> (sem. I), janë të përfshirë në këtë program studimi <b>5 PAE</b> (nga të cilët 1 Dr. Proc.) dhe <b>4 PAK</b> (nga të cilët 1 Dr. Proc).  Ngarkesa mësimore: PAE/PAK = 73% / 27%
16	Numri i studentëve (2019-2021):	40 studentë
17	Komente / të tjera:	-

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Privat "Albanian University" është licensuar me VKM Nr. 197, datë 10.04.2004 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "UFO Dental". Është ndryshuar statusi dhe është bërë riorganizimi me VKM nr.597, datë 28.5.2009 "Për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat "UFO University". Me VKM nr. 603, datë 24.8.2011 është bërë ndryshimi i emrit të universitetit privat nga "UFO University" në "Albanian University". Institucioni është riorganizuar me Urdhër të MASR Nr.52, datë 05.02.2016.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është licensuar me VKM Nr.56, datë 21.01.2009, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), 120 kredite. Ai është akredituar për herë të parë me VKA nr. 355, datë 13.07.2012 dhe riakredituar (me rekomandime) me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 80, datë 27.10. 2018.

Ky program studimi i kalon Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në bazë të: Urdhër Nr. 52, datë 05.02.2016. Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike (Vendim Senati Nr. 51/2 prot., datë 09.03.2016)-pas riorganizimit të IAL me UMAS Nr. 52, datë 05.02.2016.

Institucioni ka dërguar në ASCAL, Vendimin e Senatit dhe shkresë miratimi nga MASR për miratimin e ndryshimeve për programin MSh në "Administrim Biznesi", në masën 20%.

Programi Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është hartuar dhe ofrohet në përshtatje e zbatim të strategjisë për zhvillim të Albanian University, statutit si dhe rregullores së tij. Ky program është një program që gjendet në disa prej IAL-ve publike dhe private në Shqipëri, megjithatë AU është përpjekur të sigurojë mbarëvajtjen e këtij programi. Vlen për t'u përmendur mbështetja institucionale dhe përkushtimi i njësisë bazë ndaj këtij program studimi.

Ky është akreditim periodik për këtë program studimi.

## **SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 80, datë 27.10.2018, për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” të Universitetit Privat “Albanian University”, janë si vijon:

### **1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik me kohë të plotë, me grada dhe tituj, me qëllim mbulimin e ngarkesës së programit të studimit nga staf akademik me kohë të plotë në standardin e kërkuar, mbi 70%.**

Institucioni ka marrë masa për përmbushjen e këtij rekomandimi duke rekrutuar staf të ri akademik për departamentin, konkretisht në vitin akademik 2018-2019, janë punësuar 2 pedagogë me gradën Dr. si Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 1 pedagog me gradën Dr. si Personel Akademik me Kontratë (PAK); në vitin akademik 2019-2020 janë rekrutuar 1 pedagog me Msc (Dr – në proces) si PAE dhe 1 pedagog me gradën Dr., si PAK (referuar RVB).

Raportet PAE/PAK nga akreditimi i kaluar deri më sot paraqiten si vijon (bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në sistemin AMS:

- Viti akademik 2018-2019 (semestri I) raporti PAE/PAK = 66.8/33.2 % (Aneks [2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf](#))
- Viti akademik 2018-2019 (semestri II) raporti PAE/PAK = 76/24% (Aneks [2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf](#))
- Viti akademik 2019-2020 (semestri I) raporti PAE/PAK = 71.3/28.7 (Aneks [2.5.b Ngarkesa mësimore stafi akademik 2019-2020 S.I.pdf](#))
- Viti akademik 2019-2020 (semestri II) raporti PAE/PAK = 73/27% (Aneks [6. Ngarkesa mësimore 2019-2020 S.II.pdf](#))
- Viti akademik 2020-2021(sem I) raporti PAE/PAK = 73% / 27% (ref. [2.5.c Ngarkesa mësimore stafi akademik 2020-2021 S.I.pdf](#))

Sa më sipër GVJ konfirmon **përmbushjen e plotë të këtij rekomandimi.**

### **2. Me rekrutimin e stafit të ri akademik, institucioni, të konsiderojë dhe përputhshmërinë midis profilit akademik të stafit akademik të angazhuar dhe lëndëve që ata mbulojnë.**

Konfirmohet nga drejtuesit e programit dhe institucionit se tregu ofron mundësi zgjedhjeje për pedagogë të përshtatshëm për lëndët e këtij MSh AB. Nga ana praktike dhe eksperiencia në punë janë përzgjedhur pedagogë të përshtatshëm për lëndët përkatëse. Megjithatë, nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik të këtij programi, gjatë vizitës në institucion, vihet re se ka ndonjë mospërputhje midis edukimit / fushave të specializimit dhe moduleve që mbulohen (Ref. Aneks [R.1.e Lista e stafit akademik, ngarkesa dhe fusha e studimit.pdf](#)). Është e nevojshme që profilizimi akademik i pedagogëve për lëndët që mbulojnë të lidhet edhe më tepër me punën e tyre kërkimore të botuar ose të prezantuar në konferenca.

Sa më sipër GVJ konfirmon **përmbushjen kryesisht të këtij rekomandimi.**

**3. Institucioni të parashikojë dhe realizojë praktikën profesionale në kurrikulën e programit të studimit, si një modul të veçantë.**

Ky kriter **duket i plotësuar** pasi institucioni duket të ketë marrë masa të mjaftueshme për parashikimin dhe realizimin e praktikave profesionale. Masteri i shkencave ofron mundësi të mira për të gjithë studentët që të kryejnë praktika pranë kompanive të njohura në Shqipëri nën mbikëqyrjen e institucionit dhe si një modul i veçantë.

Sa më sipër GVJ konfirmon **përbushjen e këtij rekomandimi.**

**4. Institucioni, të rishikojë syllabuset me qëllim që përmbajtja e tyre të jetë në përputhje me emërtimin e lëndës, literatura të jetë e përditësuar dhe në përputhje me nivelin e njohurive që kërkon programi Master i Shkencave.**

Zyra e Kurrikulave kontrollon këtë proces që ndryshimet të përputhen me pjesën tjetër të programit. Përditësimi i syllabuseve ndodh rregullisht, kryesisht brenda nivelit 20% ndërmjet akreditimeve ose me shumë. Për shembull, lëndë që kanë të bëjnë me sjellje etike, burime njerëzore, menaxhimi i riskut kanë ndryshuar disa tema. Menaxhimi strategjik do të ndërrojë literaturën por po rishikohet. Degë më tradicionale si kontabiliteti nuk kanë ndryshuar ose ndryshojnë shumë pak. Me gjithë gatishmërinë nga ana e institucionit për një gjë të tillë, ky kriter **është plotësuar pjesërisht**. Ka module ku literatura tejkalon harkun kohor të 5-vjecarit të fundit, kjo e evidentuar edhe gjate vizitës në Biblioteke ku mungonin disa tituj librash.

**5. Institucioni të shtojë numrin e laboratorëve dhe zgjerojë kapacitetet kompjuterike në dispozicion të studentëve.**

Raporti nuk jep të dhëna për kapacitet laboratorike të mëparshme dhe ato ekzistuese për të lejuar një vlerësim të saktë, me gjithë gatishmërinë në nivel strategjik të institucionit. Nga takimet u konfirmua se kapaciteti i laboratorit të informatikës me 25 vende është i njëjtë. Megjithatë, në përgjigje të kushteve të Covid-19, institucioni ka marrë masa pozitive të theksuara për realizimin e mësimit online duke implementuar në shkallë të gjerë sistemin Microsoft Teams për organizimin e klasave dhe materialeve mësimore. Kapacitetet e teknologjisë së informacionit janë të kënaqshme edhe për sa i përket aksesit në internet, burimeve online, sistemeve specifike për lëndë si Financa 5 e instaluar me kërkesë të studentëve në kompjuterat e institucionit.

Sa më sipër GVJ konfirmon **përbushjen e këtij rekomandimi.**

**6. Institucioni të rrisë mbështetjen për studentët dhe stafin akademik për pjesëmarrje në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar si dhe për botime shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare me faktor impakti.**

Një raport i përgjithshme tregon gatishmërinë dhe seriozitetin e institucionit për të mbështetur punën kërkimore. Stafi ka mundësi të aplikojë për mbështetje për pjesëmarrje në konferenca dhe kërkime. Një mundësi e tillë duket se shfrytëzohet pak, megjithëse është e rëndësishme si për zhvillimin e materialeve mësimore nga vetë pedagogu në bazë të kërkimeve shkencore që ai/ajo bën, por edhe për profilizim në lëndët që japin. Gjithashtu nuk ka studentë MSh AB të përfshirë në projekte kërkimore (evidenca e vënë në dispozicion pas takimeve në institucion është e konferencës së vitit 2017, pra para akreditimit të fundit (Aneks [1. Studente pjesemarrës ne Konferenca.pdf](#)), pavarësisht mundësive që ata kanë të marrin pjesë falas në

konferencat e organizuara nga institucioni ose nëpërmjet revistës Optime. Disa pedagogë janë të motivuar të botojnë rreth 2 here në vit për arsye fitimi grade.

GVJ konfirmon **përbushjen kryesisht të këtij rekomandimi.**

**Shkalla e përbushjes së rekomandimeve:**

Institucioni ka paraqitur një përmbledhje të përgjithshme për programin Master i Shkencave Administrim Biznesi në përputhje me kërkesat e tregut dhe ligjeve në fuqi përfshirë dhe Kartën e Bolonjës.

Evidencat dhe raporti i paraqitur tregojnë qartë seriozitetin e institucionit në formën e organizimit dhe drejtimin e këtij programi duke përbushur në më të shumtën e rasteve minimumin e kriterëve të kërkuara. Për një zhvillim më ambicioz mund të ishte punuar dhe evidentuar për tejkalimin e kërkesave të kriterëve përtej minimumit të kërkuar.

Sugjerimet e dhëna në këtë raport kanë synimin jo vetëm të ofrojnë një pasqyrë të vlerësimit të dokumentuar, por edhe një mundësi për përmirësime të mëtejshme për ta bërë këtë program më të qëndrueshëm akademikisht dhe praktikisht në nivel ndërkombëtar përveç atij lokal.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe koha e vizitave në institucion janë caktuar mbështetur në VKM Nr. 109 dhe Manualin për proceset e akreditimit mbi të cilin ASCAL ushtron veprimtarinë e tij.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga PhD. Endrit Kromidha dhe PhD. Eriona Shtëmbari.

Ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion, nëpërmjet sistemit të ASCAL, i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët përgatitën draft raportin shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë takimeve me grupet e ndryshme të IAL në datat 25-26 Janar, 2021. Për shkak të situatës së pandemisë globale, pjesa më e madhe e takimeve u realizuan *online*, nëpërmjet platformës së vënë në dispozicion nga ASCAL. Gjatë këtyre takimeve u kryen diskutime intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, stafit akademik, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrativ, etj. Kurse takimi me Burimet Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore, ku ishte i nevojshëm verifikimi i dosjeve të personelit dhe regjistrave, Biblioteka dhe ambjentet mësimore, u kryen fizikisht në IAL Në DVV e përcjellë nga IAL pati disa mangësi, të cilat u kërkuar të plotësohen nga ekspertët, pas vizitës në institucion. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 27 Janar 2021, përmes sistemit të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij për përmbushjen e rekomandimeve të nga akreditimi i parë, dhe më pas vlerësimin sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë program studimi është ME. Renata Qatipi.

Më datë 04.03.2021, përmes sistemit AMS, dhe me shkresë Nr. 11/3 Prot., datë 11.03.2021, Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm. Me datë 09.03.2021, nëpërmjet AMS dhe me shkresë Nr. 153/1 Prot., datë 17.03.2021, AU përcjell disa komente në lidhje me Draft RVJ. GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit Privat AU, sqaron si më poshtë:

**Rekomandimi Nr.1, fq. 4:** *“Gjykojmë se kjo masë bie ndesh me kërkesat ligjore (Ligji 80/2015 - Neni 59, pika 6.) sipas të cilit personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi duhet të ketë një gradë më lartë se sa cikli i studimit ku japin mësim. Por ky informacion i përcjellë nga RVB, lidhur me gradat dhe titujt e stafit akademik, rezulton të jetë në kontradiktë me informacionin e pasqyruar në tabelat e ngarkesës mësimore në vijim dhe verifikimit të dosjeve gjatë takimit me Burimet Njerëzore në institucion.”*

**Koment i AU:** Sqarojmë që Departamenti i Shkencave Ekonomike ka rekrutuar si staf akademik 1 Dr. në proces, duke qenë se Departamenti ofron edhe programe të tjera. Ky pedagog nuk bën pjesë në stafin e këtij programi. Thëksojmë se në këtë program studimi, stafi akademik i angazhuar ka të paktën një gradë më lartë se sa cikli i studimit ku jep mësim. Ky informacion është paraqitur edhe në tabelat e ngarkesave mësimore të përcjella.

Për sa i përket kontradiktës së cituar, sqarojmë se teksti në faqen 19 në RVB (paragrafi parë), mbi stafin akademik të angazhuar në vitin akademik 2020-2021, ka 1 lapsus. Në këtë program studimi nuk ka asnjë

pedagog pa gradën shkencore Dr. ashtu si dhe evidentohet në tabelën 6.3 të referuar në këtë paragraf në RVB, si dhe tabelat e tjera të ngarkesës mësimore për çdo vit akademik. (pjesë e dosjes së vetëvlerësimit)

Për sa më sipër, sugjerojmë të rishikoni edhe rekomandimin për mbulimin e ngarkesës së programit të studimit nga staf akademik me kokë të plotë mbi 70%, i cili konsiderohet i përmbushur plotësisht sepse ngarkesa vjetore për secilin vit akademik (sem I+II) është mbi 70% .

- Viti akademik 2018-2019 (semestri I) raporti PAE/PAK = 66.8/33.2 % .
- Viti akademik 2018-2019 (semestri II) raporti PAE/PAK = 76/24 % .
- Viti akademik 2019-2020 (semestri I) raporti PAE/PAK = 71.3/28.7 % .
- Viti akademik 2019-2020 (semestri II) raporti PAE/PAK = 73/27 % .
- Viti akademik 2020-2021(sem I) raporti PAE/PAK = 73/27 %

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon. Rekomandimi i adresuar nga akreditimi i fundit i referohet vetëm stafit të përfshirë në programin e studimit dhe jo atij të departamentit në përgjithësi. Rekomandimi konsiderohet i përmbushur.

**Rekomandimi Nr.2, fq. 4:** *“Konfirmohet nga drejtuesit e programit dhe institucionit se tregu ofron mundësi zgjedhjeje për pedagogë të përshtatshëm për lëndët e këtij MSh AB. Nga ana praktike dhe eksperiencia në punë janë përzgjedhur pedagogë të përshtatshëm për lëndët përkatëse. Problemi i mospërputhshmërisë me studimet dhe kualifikime të mëparshme kryesisht në studime ekonomike-agrare, financë e bankë dhe lëndëve të sipërmarrjes e marketingut në këtë MSh mbetet për disa pedagogë. (Ref. Aneks R.1.e Lista e stafit akademik, ngarkesa dhe fusha e studimit.pdf) Është e nevojshme që profilizimi akademik i pedagogëve për lëndët që mbulojnë të mos justifikohet vetëm nëpërmjet eksperiencës së tyre të punës, por edhe nëpërmjet punës së tyre kërkimore të prezantuar në konferenca ose të botuar.”*

**Koment i AU:** Pedagogët e angazhuar në këtë program studimi kanë shkollim, kualifikime dhe sidomos eksperiencë të përshtatshme me lëndët që ata mbulojnë. Ju lutem, referojuni CV-ve përkatëse të dërguara. Konkretisht Prof. Asoc. Dr. E.D. ka mbi 10 punime në Marketing dhe Doktoraturën në Marketing; Dr. E.B është Zv. Drejtor i ... prej 5 vitesh tek ..., përveç shkollimit dhe disa kualifikimeve jashtë AU, si dhe botimeve në këtë fushë. Për sa më sipër, rishikoni përmbushjen e këtij rekomandimi.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ e pranon pjesërisht komentin e IAL dhe Raporti ndryshon.

**Rekomandimi Nr.4, fq. 5:** *“Me gjithë gatishmërinë nga ana e institucionit për një gjë të tillë, ky kriter është plotësuar pjesërisht. Ka module ku literatura tejkalon harkun kohor të 5-vjecarit të fundit, kjo e evidentuar edhe gjate vizitës në Biblioteke ku mungonin disa tituj librash.”*

**Koment i AU:** Siç është konstatuar dhe nga Vlerësuesit e Jashtëm në Draft RVJ në përgjigje të këtij rekomandimi si dhe në faqen 18: “Duke vlerësuar dokumentat e vëna në dispozicion për këtë program studimi, veçanërisht syllabuset e lëndëve (Aneks 2.2), mendojmë se programi ofron kryesisht literaturë bashkëkohore”, Albanian University ka marrë masa në përputhje me rekomandimin e dhënë: “Institucioni, të rishikojë syllabuset me qëllim që përmbajtja e tyre të jetë në përputhje me emërtimin e lëndës, literatura të jetë e përditësuar dhe në përputhje me nivelin e njohurive që kërkon programi Master i Shkencave.” Literatura e



ofruar është në përputhje me emërtimin e lëndës, me nivelin e njohurive që kërkon programi, si dhe është përditësuar në të shumtën e rasteve me literaturë të 5 viteve të fundit. Në rastet kur nuk ka tekst në shqip (detyrim Ligjor) të përshtatshëm me lëndën që ofrohet, referohen si literaturë e detyrueshme tekstet ekzistuese të lëndëve përkatëse, por ofrohet me zgjedhje literature bashkëkohore. Kurrikula e Msc. Administrim Biznesi është klasike dhe bazuar në kurrikula të universiteteve publike në vend e jashtë vendi. Ju lutemi të rishikoni vlerësimin e rekomandimit në përputhje me kërkesat dhe plotësimin e tij.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Institucioni pranon vërtetësinë e argumentit të GVJ në justifikimin e dhënë që kriteri është plotësuar pjesërisht.

**Standardi I.3, kriteri 1, fq. 11:** “Do ishte e vlefshme për studentë që konsiderojnë të regjistrohen në këtë MSh AB të kishin një pasqyrë të qartë të roleve që ata mund të ndërmerrnin pas diplomimit, si dhe rrogat përkatëse mesatare në bazë të dhënave që institucioni mund të zotërojë nga studentët e diplomuar më parë dhe të punësuar. GVJ sugjeron kryerjen e një analize të tregut të punës, për të evidentuar më specifikisht nevojat në lidhje me këtë MSh AB dhe mundësitë që ai jep.”

**Koment i AU:** Sugjerimi i parë nuk është i bazuar në Kriter. Për sa i përket analizës së tregut të punës, ai është pjesë e dosjes së vetëvlerësimit. DSHE realizon periodikisht studimin e tregut të punës.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Studimi i tregut paraqitur si evidence nuk jep maftueshëm të dhëna specifike për këtë program masteri.

**Standardi I.3, kriteri 5, fq. 12:** “Në një nivel më specifik kërkohet një studim dhe evidencë më e thelluar e programeve me të njëjtin emër në institucione në zë ndërkombëtare dhe tregjet ndërkombëtare të punës.”

**Koment i AU:** Ju lutem të rishikohet vlerësimi, pasi dhe komenti tejkalon kërkesat e kriterit. Programi i studimit, siç dhe vlerësuesit konstatojnë në standarde të tjera, është në përputhje me legjislacionin, direktivat, praktikat më të mira të vendit dhe përvojën disa vjeçare të institucionit.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon duke zëvendësuar fjalën ‘kërkon’ me ‘sygjeron’ në komentin më sipër.

**Standardi I.3, kriteri 8, fq. 12:** “Nuk ka evidencë të mjaftueshme që i gjithë dokumentacioni dhe aktiviteti i zhvilluar ruhet edhe në gjuhën angleze si kërkohet nga ky kriter, megjithatë institucioni ju jep mundësi studentëve të kenë akses në një sasi të caktuar dokumentacioni jo vetëm në anglisht por edhe në gjuhë të tjera.”

**Koment i AU:** Albanian University zotëron dhe përditëson informacionin e nevojshëm edhe në gjuhën angleze, sipas kërkesave të legjislacionit dhe atyre të studentëve. Këtu bëjnë pjesë kurrikulat, syllabuset, suplementin e studentit, rregullore të studentëve etj. Kjo është evidentuar dhe nga GVJ fq.53 “GVJ konstaton se informacionet lidhur me programin e studimit MSHAB, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqipe, dhe pjesa më e madhe e tyre edhe në gjuhën angleze.” Ju lutem referojuni edhe faqes zyrtare të AU, versioni anglisht.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Kriteri kërkon që ‘i gjithë’ informacioni të dokumentohet në Anglisht, dhe kjo nuk kryhet.

**Standardi I.4, kriteri 1, fq.13:** “Mbetet për t’u patur kujdes nga institucioni përputhja e kualifikimeve të mëparshme me lëndën që secili pedagog jep dhe me arritjet shkencore në po këtë drejtim përveç eksperiencës në punë që ata mund të kenë. Fakti që masteri është i nivelit shkencor kërkon një ndërthurje të praktikës me teorinë.”

**Koment i AU:** Ju lutemi referojuni përgjigjes për Rekomandimin 2.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon, bazuar në përgjigjën përkatëse për R. 2.

**Standardi I.4, kriteri 2, fq.13:** “Fakti që shkencat e aplikuara (inxhinieri dhe dizajn) janë vendosur bashke me shkencat ekonomike, dhe fakti që menaxhimi është vendosur nën ekonominë ndërkohë që zakonisht këto dy fusha konsiderohen paralelisht nuk është një praktikë e hasur rëndom në nivel ndërkombëtar.”

**Koment i AU:** Organizmi institucional i AU është miratuar dhe vlerësuar nga MASR dhe ASCAL. Për sa më sipër, sugjerojmë të rishikoni përmbushjen e Standardit I.4.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Ky është një konstatim jo në nivelin e vlerësimi pozitiv ose negativ që sipas mendimit të GVJ qëndron.

**Standardi I.5, kriteri 4, fq. 15:** “Do ishte më me vlerë që krahas formularit të vlerësimit në R2 të jepeshin dhe vlerësimet konkretë në formë të përmbledhur të këtyre praktikave pas plotësimit të këtyre formularëve.”

**Koment i AU:** Procedura e udhëheqjes dhe vlerësimit të praktikës në AU është në përputhje me rregulloren. Mendojmë që sugjerimet nuk janë kërkesë e kriterit.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon pasi institucioni nuk ka paraqitur evidencën e duhur për të vërtetuar përmbushjen e kriterit.

**Standardi I.5, kriteri 5, fq. 15:** “Do ishte me vlerë për qëllimin e këtij vlerësimi të thellohej raporti në natyrën e këtyre bashkëpunimeve për të vërtetuar që nuk mbeten në nivelin e prezantimeve të konferencave dhe mësimdhënies, por kanë karakter real kërkimor me qëllim botime në revista shkencore në zë me faktor impakti.”

**Koment i AU:** Në përmbushje të kriterit, AU garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve, ashtu siç është evidentuar dhe nga GVJ, në këtë kriter. Çdo bashkëpunim me IAL në Shqipëri e më tej ka objektiv organizimin e veprimtarive shkencore kërkimore.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Institucionit i njihet merita për garantimin e bashkëpunimeve, por njëkohësisht sygjerohet thellimi i tyre, lënë në dorë të institucionit për përmirësim të mëtejshëm.

**Standardi I.6, kriteri 4, fq.16:** “Nuk ka praktika të mirëfillta për vlerësimin e rasteve të mundshme të plagjiaturës nga vetë pedagogët në materialet dhe prezantimet që ata përdorin gjatë mësimdhënies.”

**Koment i AU:** Integriteti i stafit akademik dhe liria akademike citohen në disa rregullore të brendshme të AU. Më konkretisht referojuni Kodit të Etikës, Neni 3 dhe 4, fq.5.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon duke fshirë komentin e mësipërm.

**Standardi II.1, kriteri 2, fq. 17:** “Megjithatë, ka lëndë si Ekonometria (pjesë e modulit të metodave kërkimore) e cila nuk haset në programe të tjera të ngjashme; do të ishte më e përshtatshme të zëvendësohej me lëndë bashkëkohore të fushës së menaxhimit, si psh. “Planifikimi i Burimeve të Kompanisë” (ERP), “Lidershipi”, etj ose të ofrohej si lëndë me zgjedhje.”

**Koment i AU:** Sugjerime për t’u diskutuar nga grupet e punës në nivel Departamenti në kuadër të rishikimit të kurrikulës. Mendojmë që nuk mund të jenë pjesë e Vlerësimit të Standardit përkatës.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Ky është një sugjerim bazuar në modelet e programeve të ngjashme ku lënda e “Ekonometrisë” nuk haset në fushën e administrim biznesit por në atë të Finacës dhe Ekonomiksit, dhe jo vlerësim pozitiv apo negativ i standartit përkatës. Ky sugjerim, për të bërë edhe diferencën me MSh në Manaxhim Bankar të ofruar në AU.

**Standardi II.1, kriteri 7, fq. 19:** “Ekspertët pyetën studentët për metodat e kërkimit shkencor që ata kanë aplikuar deri tani apo që po planifikojnë të përdorin për diplomat e tyre. Rezultoi se studentët kishin njohuri të limituara mbi aktivitetet kërkimore dhe nuk janë angazhuar në projekte kërkimore apo publikime shkencore, edhe pse institucioni ka një përvojë të mirë të organizimit të konferencave apo mundësisë së publikimit në revistën Optime.”

**Koment i AU:** Kriteri referon përcaktimin e krediteve për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj, detyrime të cilat janë përmbushur për këtë program studimit. Studentët e pyetur nuk kanë qenë në proces të punimit të temës së diplomës, apo studentë të diplomuar, si rrjedhojë nuk kanë informacionin e duhur mbi ecurinë e punimit të temës së diplomës. Punimi i diplomës zhvillohet gjatë semestrit të dytë, viti II.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Komenti i GVJ i referohet metodave të kërkimit shkencor, lëndë e cila ofrohet në semestrin I të vitit të parë.

**Standardi II.1, kriteri 6, fq. 19:** “Gjatë intervistave me grupe të ndryshme, na u referua se praktikisht studentët bien dakort se cila prej lëndëve me zgjedhje do t’u ofrohet. Vihet re se ndër lëndët me zgjedhje janë ofruar vetëm dy dhe dy të tjerat (“E Drejtë Tregëtare” dhe “Manaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin”) asnjëherë (referuar të dhënave mbi ngarkesat e të stafit (Anekset 2.5.a,b,c dhe 6)”

**Koment i AU:** Vlerësuesit kanë identifikuar që program i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore si dhe element e nevojshëm për realizimin e tij. Për sa më sipër, mendojmë të rishikohet vlerësimi për Standardin II.1

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Ky është një konstatim i GVJ i shoqëruar me një sugjerim dhe jo vlerësim pozitiv apo negativ i standartit përkatës

**Standardi II.3, kriteri 5, fq.23:** “Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë takimit me stafin mësimdhënës, sekretarinë mësimore dhe studentët e programit, se institucioni nuk aplikon kritere specifike dhe të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve dhe sidomos të atyre që vijnë nga fusha të tjera studimi, por kjo parashikohej si

*një objektiv për të ardhmen. GVJ rekomandon vendosjen dhe publikimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në funksion të procedurave të përcaktuara në rregulloret e tij.”*

**Koment i AU:** Përzgjedhja e kandidatëve për student në programin Msc. Administrimi Biznesi bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Institucioni informon në faqen e tij zyrtare për kriteret si dhe sqaron të interesuarit nëpërmjet zyrës së Regjistrimeve dhe Transferimeve.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Sugjerimi i GVJ i referohet kriterëve specifike (jo të përgjithshme) sic kërkohet nga standarti nën vlerësim, për pranimin e studentëve me përgatitje bachelor nga një fushë tjetër studimi, të cilëve ju mungon baza e njohurive të fushës së biznesit, gjë e cila krijon vështirësi për asimilimin e njohurive të reja në lëndët e avancuara (p.sh. Manxhim Projekti i Avancuar). Gjithashtu, rregulloret e cituara nuk parashikojnë specifikisht kriteret e veçanta për pranimin e studentëve me profil të ndryshëm nga ai i MShAB (psh. IAL mund të ofrojë kurse të detyrueshme përgatitore, me njohuritë bazë, të nevojshme për mbarëvajtjen e studentëve të fushave të tjera në këtë program). Nga verifikimi I bërë në web-faqen e institucionit, nuk kishte kriteret të tilla të publikuara.

**Standardi II.4 , kriteri 1, 2, 3, fq.25:** *“Lidhur me angazhimin që kanë studentët në konferenca studentore, vlen sugjerimi i mësipërm për nxitjen e angazhimit të tyre jo vetëm në ndonjë prezantim por edhe në ndonjë punim shkencor me qëllim publikimin e tij.”*

**Koment i AU:** Ju lutemi të rishikoni sugjerimin, pasi mendojmë që nuk është në përputhje me kriteret.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Kriteri I referohet edhe aftësimin të studentëve në kërkimin shkencor.

**Standardi II.4 , kriteri 8, 9, 10, fq.26:** *“Rekomandohet thellimi i studentëve me projekte konkrete në fushën e metodave kërkimore, për të nxitur përgatitjen e tyre për të avancuar në studime shkencore më të avancuara, si psh studimet në doktoratë.”*

**Koment i AU:** Mendojmë që rekomandimet e GVJ janë përmirësime për të ardhmen. Ju lutem të rishikoni vlerësimin e Standardit II.4.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Aktualisht program nuk nxit përgatitjen për ciklin e tretë të studimeve.

**Standardi II.5, kriteri 3, fq.28:** *“Rekomandohet të nxitet më tepër angazhimi i personelit për të zhvilluar specializime në fusha studimi që mund të përkrijnë me fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit.”*

**Koment i AU:** DSHE ka përmbushur Standardin II.5 “Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, siç dhe evidentohet nga GVJ. Ju lutemi, të rishikohet vlerësimi i standardit pasi ka vetëm këtë rekomandim, i cili është në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, por nuk mund të ndikojë në vlerësimin përfundimtar.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Ref. përgjigjes per R.2 Per me teper, vleresimi I ketij standarti I referohet edhe permbushjes se pjeshme te kritereve 1&2.

**Standardi II.6, kriteri 2, fq.29:** “Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se studentët nuk janë të përfshirë në diskutime si dhe gjithashtu rezultatet e pyetësorëve nuk janë reflektuar në masa konkrete në funksion të përmirësimit të programit të studimit.”

**Koment i AU:** Gjatë takimit me GVJ, janë vënë në dijeni se studentët përfshihen në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Rast konkret i paraqitur ka qenë dhe kërkesa e studentëve për mundësimin e programit “Financa 5”, reflektuar në fokus grupet e studentëve të realizuara nga NjSBC e cila është realizuar. (Evidencë 1 – Shkresë realizimi i focus grupeve)

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon. Reflektuar ne standartin perkates.

**Standardi II.7, Kriteri 5, fq.31:** “GVJ rekomandon që Institucioni të hartojë një fond të veçantë në buxhet për aktivitete kërkimore si edhe të hartojë dhe shpallë kritere për aplikimin e një politike financimi në mënyrë të barabartë të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MSHAB.”

**Standardi II.8, Kriteri 3, fq. 32:** “Institucioni nuk disponon një procedurë transparente për alokimin e fondeve në kuadër të kërkimit shkencor. Sikurse përmendur edhe më sipër, GVJ, rekomandon që këto bashkëpunime të rriten në numër dhe institucioni të hartojë dhe shpallë kritere për aplikimin e një politike financimi në mënyrë të barabartë të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MSHAB.”

**Standardi IV.2, Kriteri 2, fq.49:** “Përmendur edhe më lart, nuk ka evidenca lidhur me shpërndarjen dhe politikën që institucioni ka ndjekur në alokimin e fondeve kërkimore-shkencore midis stafit akademik. Ekspertët rekomandojnë që institucioni të hartojë politika motivuese e stimuluese për stafin akademik të programit drejt një kërkimi shkencor të vazhdueshëm, duke mos e limituar vetëm me mundësitë institucionale, por zgjeruar edhe me pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikime në revista shkencore prestigjioze jashtë vendit.”

**Koment i AU:** Për vitit fiskal 2021 buxheti i parashikuar për kërkimin shkencor është në masën 9.432.000 shifër që përbën 2.4 % të totalit të buxhetit. Gjithashtu janë miratuar me propozim të Senatit Akademik dhe miratim të Bordit të Administrimit edhe shuma në masën 101.000 euro për pjesëmarrje në projekte kërkimore – shkencore. Kjo shumë është 3.2 % të totalit të buxhetit të miratuar, e cila e rrit përqindjen e shpenzimeve për kërkim shkencor në total, në masën 5.6 %. Kriteri kryesor i përzgjedhjes për stafin e brendshëm të “Albanian University” në lidhje me aktivitetet shkencore si pjesëmarrje në konferenca, botime dhe projekte që respektojnë orientimet e kërkimit shkencor që parasheh “Strategjia e përmirësuar të Kërkimit Shkencor 2017-2022 të Albanian University, e miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr.121/2 të datës 21.01.2018 në nivel të njësisë bazë dhe njësisë kryesore”.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Vendimet e Senatit Akademik të përmendura më sipër për sa i përket fondeve për kërkim shkencor dhe rregullave të vënies në dispozicion të tyre sygjerohet të zëvendësohen me politika të formalizuara në rregullore.

**Standardi III.2, Kriteri 4, fq.35:** “Kompetenca e stafit akademik për mësimdhënie jepet e mirëqene. Shpjegohet se stafi akademik angazhohet në nxitjet e studentëve dhe mësimxënie nëpërmjet detyrave të kursit dhe aktiviteteve për çdo lëndë. Do ishte me vlerë për të treguar më qartë përmbushjen e këtij kriteri të jepej numri dhe kualifikimi i stafit akademik në fushën e pedagogjisë në përgjithësi. Në fushën e administrimit biznesit në veçanti kjo mund të jepej nëpërmjet CV-ve, certifikatave dhe kurseve të kryera nga stafi. – trajnime stafi akademik.”

**Koment i AU:** AU, nëpërmjet NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të mësimdhënies, çdo vit akademik. Referoju 3.5a, 3.5b për vitin 2018-2019 dhe 2019-2020. Për vitet 2016-2017 dhe 2017-2018 i gjeni bashkëngjitur, me tema si: Kurrikula e bazuar në kompetenca, Metodologjia e mësimdhënies, Edukimi në vazhdim, Të mësuarit mbi bazën e kompetencave, Të mësuarit modular, etj. (Evidencë 2.1, 2.2)

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon duke lënë komentin: “AU, nëpërmjet NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të mësimdhënies, çdo vit akademik.”

**Standardi III.3, Kriteri 3, fq.37:** “Mund të konsiderohet në të ardhmen më shumë infrastrukturë me programe kompjuterike më të specializuara edhe për kërkime cilësore, ose simulime biznesi për edukim.”

**Standardi III.3, Kriteri 6, fq.38:** “Duhet patur kujdes me faqe si <https://z-lib.org/> të përmendura në RBV për plotësimin e këtij kriteri dhe nëse ato respektojnë të drejtat e autorëve dhe botuesve për artikujt shkencorë që ofrojnë falas.”

**Standardi III.3, Kriteri 9, fq.38:** “Do ishte me vlerë dhe të shikohej mundësia e Moodle (open source) ose Blackboard a Canvas për një menaxhim më të mirë të materialit të lëndëve në mënyrë të integruar me sekretarinë mësimore.”

**Koment i AU** Standardi III.3, kriteri 3, 6, 9: Sugjerimet janë mundësi për përmirësim të vazhdueshëm, por nuk cenojnë përmbushjen e kriterëve përkatëse. Mendojmë rishikimin e vlerësimit të Standardit III.3.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. GVJ mendon se sa më sipër çenojnë përmbushjen e kriterit.

**Standardi III.6, Kriteri 4, fq.42:** “Për komponentin tjetër prej 20-40% të notës në bazë të pjesëmarrjes dhe një detyre dytësore nuk ka evidencë që ruhet anonimiteti sipas rregullores e MSh AB të paraqitur si evidencë (H3 kreu IV). Gjithashtu, nuk shpjegohet si ruhet anonimiteti ose vlerësimi i drejtë i provimeve ose detyrave të kursit të tjera ose jo me shkrim”

**Koment i AU:** Anonimiteti i provimeve ruhet nëpërmjet procedurës së sekretimit të tezës, nëpërmjet barkodeve individuale. Nga ana tjetër, detyrat e kursit nuk janë anonime.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon. Komenti nuk i referohet provimeve por metodave të tjera të vlerësimit.

**Standardi IV.3, Kriteri 3, Fq.51:** “...laboratori i teknologjisë nuk është i pajisur plotësisht me programe softëarike specifike të lidhura me këtë MSh AB, sidomos të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit shkencor cilësor. GVJ rekomandon që AU të pajisë laboratorin e teknologjisë me programe softëarike, si psh. SPSS, EVieës si edhe NVivo ose Atlas.ti, etj. të nevojshme për

*përpunimin dhe analizimin e të dhënave gjatë kërimit shkencor sasior dhe cilësor si të stafit akademik ashtu dhe të studentëve.”*

**Koment i AU:** Studentë kanë të shënuar në çdo syllabus OJA (orë studimi jashtë auditorit) që i përdorin për të realizuar detyrat e tyre. Softëare që janë të domosdoshëm për demonstrimin e lëndëve gjenden në laborator. Sugjerimi i GVJ për pajisjen e Laboratorit me softëare të tjerë nuk mund të ndikojë në vlerësimin e Standardit.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Standarti I referohet përdorimit të teknologjise për formimin kerkimor të studenteve (përtej detyrave të kursit), objektiv ky që dominon në një program MSh.

**Koment i AU për Standardi IV.5, fq.53:** Ju lutem të rishikohet vlerësimi, meqenëse nuk ka konstatime për mos përmbushje të kriterëve përkatëse

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **e pranon komentin e IAL** dhe Raporti ndryshon. Lapsus, u reflektua ndryshimi i vlerësimit të standartit, por kjo gjithsesi nuk ndryshon vlerësimin e fushes në teresi.

**Standardi IV.6, Kriteri 1, 2, fq. 53:** “*Megjithatë, GVJ gjykon të nevojshme që institucioni të hartojë raporte financiare si dhe planin për mbështetjen financiare të detajuar për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit MShAB referuar kohës të këtij cikli studimi 2-vjeçar.”*

**Standardi IV.6, kriteri 3 fq. 54:** “*Bazuar në kriterin 3, GVJ rekomandon që institucioni, përtej dokumentimit të gjendjes financiare, të vlerësojë edhe efektivitetin financiar të programit MSh AB, si dhe mundësitë e gjenerimit e të ardhurave të domosdoshme për të garantuar qëndrueshmërinë e tij financiare”.*

**Koment i AU:** Në përputhje me raportet financiare të miratuara institucioni në përgjithësi dhe programi i studimit në veçanti garantojnë mbarëvajtjen e këtij programi. Nisur nga kjo, përlllogaritja e kostos për student është 121.000 lekë (përfshihen edhe kostot e tjera të shërbimit dhe administrimit), e cila e bënë këtë program studimi efektiv nga pikëpamja financiare dhe garanton qëndrueshmëri.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Keto informacione dhe analiza duhet të përfshihen në raporte periodike të shoqeruara me plan masash për të ardhmen, evidence të cilat mungojnë.

**Standardi VI.2, kriteri 1, fq. 68:** “GVJ sugjeron përfshirjen e ekspertëve të jashtëm si dhe një anëtar nga stafi administrativ në Rregulloren e kësaj njësie.”

**Koment i AU:** Bordi i AU ka miratuar me Vendim Nr.51, dt.15.10.2018 (evidenca 6.5.a në dosjen e vetëvlerësimit), si konsulentë juridike Znj. Entjola Pano, pranë NJSBC. AU ka burime njerëzore të specializuara për të mbuluar kriterin. Vetëm ky sugjerim nuk mund të ndikojë në vlerësimin e standardit VI.2, Ju lutemi të rishikoni vlerësimin përfundimtar.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Sugjerimi i GVJ I referohet përfshirjes në Rregulloren e NJSBC.

**Standardi VI. 3, fq.70:** “Qëndron rekomandimi i mësipërm që institucioni të konsultohet edhe me punëdhënësit dhe biznese të ndryshme lidhur me nevojat e tregut të punës si dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit.”

**Koment i AU:** Mendimi i disa punëdhënësve merret gjatë analizës së tregut të punës. Mendojmë të rishikohet vlerësimi i standardit, pasi AU nëpërmjet NjsBC, përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese të mjaftueshme për ecurinë e programit të studimit.

#### **Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Rekomandimi lidhet vetëm me marrjen e mendimeve punëdhënësit dhe biznese të ndryshme lidhur me nevojat e tregut të punës dhe alizimin e tyre për mbarëvajtjen e cilesise se programit, por jo me metodat e përdorura nga NJSBC.

**Standardi VI. 4, fq.71:** “Rregullorja e NJSBC përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë në tërësinë e tyre, por mungon një dokument i cili specifikon përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të njësisë.” “GVJ rekomandon si edhe më lart, përfshirjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm nga tregu i punës si dhe një anëtar nga stafi administrativ në këtë njësi.”

**Koment i AU:** Detyrat dhe përgjegjësit e çdo anëtar të njësisë janë përcaktuar në kontratën individuale të punës. Për sa i përket vlerësimeve nga bashkëpunëtorë të jashtëm, pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm janë dhe konstatimet, rekomandimet e Grupeve të Vlerësimit të Jashtëm, të cilave AU i kushton shumë rëndësi. Stafi administrativ është pjesë e NjsBC, MSc. Eni Boçi (juriste) dhe MSc. Redina Birbili (asistente). (Paraqitur në evidencën 7, kërkuar gjatë vizitës në AU)

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Ref. përgjigjes se mesiperme per Standardi VI.2.

**Standardi VI.5, kriter 2, fq.72:** “GVJ rekomandon që institucioni të integrojë në raporte në bazë programi ku të përfshihen analiza mbi vlerësimet e përmirësimit të mangësive dhe dobësive të evidentuara dhe plan programi në periudhat e ardhshme (Aneks 3.2 paraqet vetëm formular bosh).”

**Koment i AU:** AU bën me dije çdo pedagog dhe diskuton në mbledhje formale departamenti rezultatet e vlerësimeve të lëndëve, të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Model i plotësuar evidencë 3.2 bashkëngjitur.

**Përgjigje e GVJ:** Në përfundim GVJ **nuk e pranon komentin e IAL** dhe Raporti nuk ndryshon. Analizat dhe masat e marra mungojne.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/ “Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” (më tej Msh në AB) është në përputhje me interesat kombëtare në nivel kulturor, ekonomik, atë të punësimit dhe ndërkombëtar. Kjo tregohet dhe në objektivin strategjik 2 te Planit Strategjik te Zhvillimit Institucional 20 17-2022 [Evidence 1.1] ku pesë pikat e para janë:  a. të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;  b. të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;  c. të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat qe ajo mbulon dhe të përgatisë specialiste dhe shkencëtarë të rinj;  d. të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese;  e. te ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i larte gjate gjithë jetës.  <a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Vlerat kulturore kombëtare mbështeten nëpërmjet orientimit të programit të studimit nga nevojat e ekonomisë dhe tregut të punës në Shqipëri (Aneks 3). Programi i studimit i përmbahet standardeve të edukimit ekonomik dhe etikes, veçanërisht në lidhje me antikorrupsionin dhe parimet e drejta të biznesit në lëndët "Qeverisja e Korporatave", "Sjellja Organizative dhe Etika ne Biznes", "E Drejta Tregtare” të dhëna si shembuj, dhe në mënyrë të përmbledhur në programin mësimor në tërësi.  <a href="#">3. Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Evidenca e paraqitur në Dosjen e VB tregon se jo vetëm që programi i studimit hartohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, por ai përditësohet nga Zyra e Zhvillimit te Kurrikulave [Evidence 1. 1]. Misioni mund të shtrihet më gjerësisht përtej hapësirës Evropiane të arsimit të lartë të përmendur ne Evidencën 1.1.  <a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në	Programi i studimit ka lëndë që nxisin zhvillimin ekonomik të vendit. Ndër to mund të përmenden si shembuj: “Menaxhim Marketingu dhe Biznes

përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p><i>Ndërkombëtar", "Sipërmarrja e Biznesit te Vogël", "Menaxhim Projekti i Avancuar" etj. që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar dhe me interesat e punësimit të punëdhënësve dhe studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca mund të ishte plotësuar me shembuj punësimi në këto fusha.</i></p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	<p>Institucioni tregon interes drejt tregut të punës dhe njohurive të studentëve që të jenë të thelluara për të pasur sukses në të.</p> <p>Profilet e stafit akademik dhe studentëve duket të jenë më të lidhura me studimet ekonomike. Kjo ju vlen në veçanti studentëve të punësuar tashmë në banka ose organizata publike. Sipas evidencës 1.2 a dhe b., lende si “Metoda Kërkimi dhe Ekonometri” kanë vlerë për aftësim të thelluar shkencor për ciklin e tretë, dhe për këtë institucioni duhet t’i nxisë studentët të përfshihen më tepër në aktivitete kërkimore, p.sh mund t’i ngarkohen detyra të tilla si artikuj revistash kërkimore apo rishikim literature si kërkesë brenda moduleve të ndryshme.</p> <p>Ndërsa lëndët “Menaxhimi Sistemeve të Informacionit” dhe “Menaxhimi Marrëdhënieve me Klientin” janë më të vlefshme për anën profesionale.</p> <p><a href="#">1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi”, (më tej MSH AB), është hapur dhe ofrohet në përputhje me interesat akademike dhe kombëtare në Shqipëri, sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Së pari zbaton legjislacionin shqiptar</li> <li>• Së dyti e tregon këtë në të gjithë dokumentacionin dhe veçanërisht rregulloret e paraqitura</li> <li>• Së treti tregohet edhe konkretisht në objektivin strategjik 2 te Planit Strategjik te Zhvillimit Institucional 2017-2022</li> </ul> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i	Drejtimit prioritar janë përcaktuar më qartë në Planin Strategjik [Evidence 1.1.] ku tre të parat për ilustrim janë:

<p>studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>të krijojë, te transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;</li> <li>të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;</li> <li>të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj;</li> </ul> <p>Në vijim Rregullorja [Evidence 1.4.] përcakton strukturat organizative për të arritur këto objektiva.</p> <p><a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a></p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i programit "Master i Shkencave ne Administrim Biznesi" është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. [Evidence H.3].</p> <p>Vendosja e fushës së menaxhimit nën ekonomi nga ana praktike ka kuptim, sidomos në lidhje me profilin e studentëve që ndjekin këtë master dhe studimet e tyre të mëparshme bachelor të përqendruara po në këtë drejtim, por nga ana shkencore mund të kërkojë një rishikim. Ndërsa ekonomia si shkencë fokusohet te tregu, menaxhimi fokusohet te organizatat. Të dyja ofrojnë përjasje paralele, për këtë arsye ndërvarësi ndaj njëra-tjetres do ishte më e saktë se nën-varësia aktuale e menaxhimit nga ekonomia.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Evidenca e paraqitur 1.1 dhe 1.2 a, b tregon qartë përputhjen e këtij programi me prioritetet dhe fushat e interesit kombëtare. Në veçanti, Evidenca 1.2a tregon se Shqipëria ka produktivitetin më të ulët të punës në rajon. Për këtë arsye MSh AB në shqyrtim ndihmon në zhvillimin e këtyre kapaciteteve kryesisht për studentë që gjatë ndjekjes së këtij programi janë kryesisht të punësuar në banka, institucione publike dhe korporata.</p> <p><a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a></p> <p><a href="#">1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf</a></p> <p><a href="#">1.2.b Pyetësori për studimin e tregut të punës.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi I.3

**Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Mendohet, siç paraqitet në RVB, se programi është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe ofron aftësitë e nevojshme për këtë treg.</p> <p>Do ishte e vlefshme për studentë që konsiderojnë të regjistrohen në këtë MSh AB të kishin një pasqyrë të qartë të roleve që ata mund të ndërmerrnin pas diplomimit, si dhe rrogat përkatëse mesatare në bazë të dhënave që institucioni mund të zotërojë nga studentët e diplomuar më parë dhe të punësuar.</p> <p><i>GVJ sugjeron kryerjen e një analize të tregut të punës, për të evidentuar më specifikisht nevojat në lidhje me këtë MSh AB dhe mundësitë që ai jep.</i></p> <p><a href="#">1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Evidence e paraqitur në 1.2 a jep një vlerësim të përgjithshëm për tregun e punës.</p> <p><i>Është e vështirë të gjendet në këtë raport ndonjë e dhënë specifike për nevojën në rritje ose kërkesën ekzistente për të diplomuar në MSh AB, ndërkohë që përmendet qartë aty nevoja për me tepër të diplomuar në shkenca ekzakte. Numri i studentëve në këto tre vitet e fundit ka qenë relativisht i qëndrueshëm, rreth 20, por më i ulët se në vitet e mëparshme kur masteri ka patur edhe rreth 40 studentë. Institucioni duhet të mbikëqyrë vazhdimisht nevojën e tregut të punës me një vizion drejt të ardhmes.</i></p> <p>Programi kontribuon në nivelin relativisht të ulët të kualifikimit në Shqipëri krahasuar me vende të zhvilluara Evropiane.</p> <p><a href="#">1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat specifike të programit të studimit janë parashtruar qartë në raport.</p> <p>Lëndët dhe struktura e programit në Evidencën H.3 tregojnë qartë se lëndët e ofruara mbulojnë funksionet kryesore të bizneseve nga ana analitike dhe praktike.</p> <p><i>Nevojat specifike të tregut të punës në zhvillim mund të adresohen në të ardhmen me lëndë më specifike me zgjedhje.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Në hartimin e këtij programi MSh AB janë marrë parasysh kriteret dhe programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Sidoqoftë, formati dhe lëndët e masterit mbeten të varura dhe të lidhura ngushtë me programet e ofruara në vend pasi kërkesa e përputhjes në masën 70% të paktën me studimet bachelor e kushtëzon një gjë të tillë (sipas Rregullores së MSh AB). Ky kriter detyron në një masë të madhe që MSh AB të ofrojë lëndë në përputhje me institucionet arsimore vendase dhe në vazhdim me tregun e punës i cili është strukturuar gjithashtu kundrejt një profilizimi ekonomik, financiar dhe bankar.</p>

	<a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a> <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.	Përputhja e programit me Kartën e Bolonjës dhe Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë janë të qarta në një nivel strategjik dhe të përgjithshëm. <i>Në një nivel më specifik syzjerohet një studim dhe evidencë më e thelluar e programeve me të njëjtin emër në institucione në zë ndërkombëtare dhe tregjet ndërkombëtare të punës.</i> <a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Praktika mësimore është evidentuar qartë në Evidencën 1.5 dhe H3 fq. 7. Institucioni ka marrëdhënie me rreth 25 kompani për praktika mësimore. Sidoqoftë, një mundësi e tillë është me zgjedhje për studentët e MSh AB dhe nuk përdoret nga shumë prej tyre pasi shumica e tyre janë të punësuar në profil gjatë ndjekjes së këtij masteri. <a href="#">1.5 Syllabusi i lëndës praktikë mësimore.pdf</a> <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit e institucionit.	Materialet mësimore dhe librat në këtë program MSh AB jepen kryesisht në shqip. Ka shembuj materialesh dhe literature shtesë për tema në lëndë të ndryshme që jepen në Anglisht. Biblioteka gjithashtu ofron kryesisht literature në shqip, por databaset online për literaturë shtesë ju japin mundësi studentëve të lexojnë më tepër në gjuhë të tjerat dhe kryesisht anglisht. Nuk ka shembuj studentësh nga vende të tjera në këtë MSh AB dhe studentët në këtë master nuk marrin pjesë në programet e mobilitetit si Erasmus pasi ato janë më tepër për nivelin bachelor. <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	<i>Nuk ka evidencë të mjaftueshme që i gjithë dokumentacioni dhe aktiviteti i zhvilluar ruhet edhe në gjuhën angleze si kërkohet nga ky kriter, megjithatë institucioni ju jep mundësi studentëve të kenë akses në një sasi të caktuar dokumentacioni jo vetëm në anglisht por edhe në gjuhë të tjera.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi I.4

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura	Tabelat përmbledhëse 1 dhe 2 dhe dy japin të dhëna mbi numrin e stafit të përfshirë në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe

<p>në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Departamentin e Shkencave Ekonomike në veçanti. Nga këto të dhëna vihet re një rënie e numrit të stafit nga 112, në 107 dhe se fundmi për 2020-2021 në 88 në nivel fakulteti. Për Departamentin e Shkencave Ekonomike specifikisht të dhënat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 22 PAE dhe 22 PAK në 2018 – 2019</li> <li>• 19 PAE dhe 19 PAK në 2019 – 2020</li> <li>• 15 PAE dhe 15 PAK në 2020 – 2021</li> </ul> <p>Nga vizita dhe takimi me burimet njerëzore u evidentua se institucioni ruan dokumentacion të plotë për pedagogët e punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në këtë MSh AB.</p> <p><i>Mbetet për t'u patur kujdes nga institucioni përputhja e kualifikimeve të mëparshme me lëndën që secili pedagog jep dhe me arritjet shkencore në po këtë drejtim përveç eksperiencës në punë që ata mund të kenë. Fakti që masteri është i nivelit shkencor kërkon një ndërthurje të praktikës me teorinë.</i></p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi MSh AB ofrohet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamentin e Shkencave Ekonomike në veçanti.</p> <p>Fusha e përgjithshme e programit të studimit si rrjedhojë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore për sa i përket fushës së ekonomisë, por jo detyrimisht Departamentit të Inxhinierisë dhe atij të Art Dizajnit që janë në të njëjtin fakultet.</p> <p>Sa më sipër ndjek kryesisht direktivat kombëtare por që në shumicën e rasteve janë në përputhje me ato Evropiane nëpërmjet Kartës së Bolonjës.</p> <p><i>Fakti që shkencat e aplikuara (inxhinieri dhe dizajn) janë vendosur bashke me shkencat ekonomike, dhe fakti që menaxhimi është vendosur nën ekonominë ndërkohë që zakonisht këto dy fusha konsiderohen paralelisht nuk është një praktikë e hasur rëndom në nivel ndërkombëtar.</i></p> <p><a href="#">1.6 Rregullore e FSHAE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p>	<p>Në përgjigje të këtij kriteri në RBV konfirmohet se programi studimit është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe Evropiane. Për më tepër, përmendet se ky MSh AB është i ngjashëm me programe të tilla të ofruara nga institucione të arsimit të lartë publik në Shqipëri. Nga një shqyrtim i lëndëve të ofruara në këtë MSh AB konfirmohet që programi është i ngjashëm edhe me programe të tjera të ngjashme në botë. Programi nuk është ndërdisiplinor, megjithëse ofrohet nga një fakultet ndërdisiplinor.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Institucioni ka një strukturë të qartë organizative, dhe një proces të detajuar për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e departamentit dhe fakultetit që në mënyrë indirekte nënkupton dhe mbarëvajtjen e programit.</p> <p>Në mënyrë specifike, detyrat dhe rolet e Senatit, Rektoratit, Dekanatit Drejtuesit të Departamentit përcaktohen qartë në Evidencën 1.4 për Albanian University, dhe për Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe të Aplikuara në Evidencën 1.6. Në këto dokument shpjegohen qartë mënyra e funksionimit të stafit, programeve e ciklit të dytë dhe të tretë, mënyrat e vlerësimit, mbarëvajtja dhe organizimi i fakultetit ku bën pjesë ky MSh AB.</p> <p><a href="#">1.6 Rregullore e FSHAE.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	<p>Sipas RVB Tabelës 5 listohen 25 organizata partnere për praktika mësimore dhe 11 organizata partnere për projekte, aktivitete dhe shkëmbim stafi.</p> <p>Organizatat e sipërpërmendura janë kryesisht të bazuara brenda vendit. Përmenden në raporte organizata partnere në Kine, Poloni, Rusi, Zvicër dhe Kosovë për projekte bashkëpunimi, jo detyrimisht të lidhura me këtë MSh AB.</p> <p><i>Sugjerohet që të thellohet bashkëpunimi me organizata perëndimore dhe universitete të tjera me renditje të mirë për projekte dhe shkëmbime.</i></p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<p>Institucioni është fokusuar kryesisht në marrëdhënie me kompani për kryerjen ose ofrimin e praktikave mësimore. Evidentohen 25 partneritete të tilla. Në nivelin e shkëmbimeve shkencore dhe kërkimore mund të bëhet më shumë për të thithur fonde në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Institucioni ka gjithashtu eksperiencë pozitive në organizimin e konferencave në bashkëpunim me organizata të tjera, dhe ka marrë kërkesa bashkëpunimi për studime nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Arkiva dhe Parlamenti.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me 25 organizata dhe kompani për praktika mësimore. Disa nga ato janë Capital Invest sh.a., ANAS sh.p.k, Ferlut sh.a., Alba Trans sh.p.k., ProCredit Bank etj.</p> <p>Drejtuksi i Departamentit është përgjegjës të caktojë një pedagog lënde për praktikantët mësimorë. Në evidencën R2 paraqitet formulari që përdoret nga institucioni për mbarëvajtjen e këtyre praktikave. <i>Do ishte më me vlerë që krahas formularit të vlerësimit në R2 të jepeshin dhe vlerësimet konkretë në formë të përmbledhur të këtyre praktikave pas plotësimit të këtyre formularëve.</i></p> <p><a href="#">R.2 Formulari i ndjekjes së praktikës mësimore.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni dhe në veçanti Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ku bën pjesë ky program MSh AB organizon Konferencën Ndërkombëtare me Universitetin Bujqësor, si dhe me Kolegjin Qiriazi dhe Sapienza në Romë. Ndërkohë revista Optime, një bashkëpunim me AMF për edukimin financiar, çmime nga aktorë tregu dhe rreth 12 marrëveshje e universitete të tjera jashtë vendit ju japin mundësi stafit të promovojnë dhe shkëmbejnë dijet kërkimore.</p> <p><i>Do ishte me vlerë për qëllimin e këtij vlerësimi të thellohej raporti në natyrën e këtyre bashkëpunimeve për të vërtetuar që nuk mbeten në nivelin e prezantimeve të konferencave dhe mësimdhënies, por kanë karakter real kërkimor me qëllim botime në revista shkencore në zë me faktor impakti.</i></p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësjëria përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Është pozitiv fakti që në mbledhjet e Departamentit shqyrtohen dhe diskutohen marrëveshjet me institucione të tjera. Gjithashtu ju jepet mundësia pedagogëve të konsiderojnë pjesëmarrjen në konferenca ose të kryejnë kërkime shkencore duke edhe aplikuar për fonde pranë institucionit megjithëse një praktikë e tillë mbetet në dorë të organeve vendimmarrëse.</p> <p><i>GVJ rekomandon të konsiderohen dhe paraqiten raporte analitike të përfitimit nga marrëveshjet që institucioni dhe programi kanë.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi I.6**  
**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në</p>	<p>Institucioni ka një traditë pozitive të organizimit të Konferencës Ndërkombëtare përveç vitit të fundit për arsye të tërmetit. Ndërkohë revista Optime e vetë Albanian University siguron një mundësi komode për botime. Marrëveshja me</p>



<p>fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>AMF (Evidenca 1.7) zgjeron mundësitë e bashkëpunimeve për kërkime shkencore.</p> <p><a href="#">1.7 Marrëveshje me AMF.pdf</a></p> <p><a href="#">3.8 Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore DSHE 2020-2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Vlerësimi i ecurisë së rezultateve në fushën kërkimore kryhet nga drejtuesi i Departamentit në bazë të udhëzimit të MASR dhe zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike pranë Albanian University. Këto struktura sa më sipër mbështesin plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><a href="#">3.8 Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore DSHE 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">1. Studente pjesëmarrës ne Konferenca.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Objektivi 3 i Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017- 2022 [Evidence I. I] synon integrimin e kërkimit me mësimin. Institucioni organizon leksione të hapura ku mund të marrin pjesë edhe studentët e këtij MSh AB, sidomos duke patur parasysh se temat dhe folësit në këto leksione janë me interes për lëndët e këtij programi.</p> <p>Ndërkohë, neni 2 pika c. e Kodit të Etikës (Evidenca 1.8). konfirmon përmbushjen e këtij kriteri në sa më poshtë:</p> <p>c. të favorizojë, në rastin e kërkimeve kolektive, mënyra korrekte të rezultateve të hartuara që evidentojnë dhe deklarojnë kontributin e secilit pjesëmarrës.</p> <p><i>Nxitja e punimeve kërkimore nëpërmjet stimujve financiarë ose në formë të tjera të paracaktuara dhe standardizuara do ishte një praktikë e mirë për ta konsideruar në të ardhmen.</i></p> <p><a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Në bazë të Evidencës 1.8 vërtetohet angazhimi i institucionit për zbatimin rigorozisht të rregullave në fushën e pronësisë intelektuale, në lidhje me mënyrën e publikimit të rezultateve të studimeve dhe kërkimeve, duke i dhënë rëndësinë e duhur rezultateve të arritura nga të tjerë kërkues dhe studiues siç shprehet shprehimisht në Neni 2 pika e. e Kodit të Etikës (Evidenca 1.8).</p> <p><a href="#">1.8 Kodi Etikës.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Institucioni organizon konference, ka një botim të vetin Optime, dhe nxit pjesëmarrjen në konferencën e organizuar nga AMF.</p> <p><i>Numri ose përqindja e studenteve të MSh AB në shqyrtim që marrin pjesë në këto konferenca ose që botojnë është i ulët, kryesisht për mos-interesim të vetë studentëve, por ka përjashtime. Institucioni ofron akses në literaturë kërkimore, por burimet financiare janë të kufizuara për kërkim shkencor.</i></p> <p><a href="#">1. Studente pjesëmarrës ne Konferenca.pdf</a></p> <p><a href="#">3.8 Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore DSHE 2020-2021.pdf</a></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit MSh në Administrim Biznesi, është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (L. 80/2015 &amp; VKM Nr. 41 datë 24.01.2018).</p> <p>Programi i studimit Msc në “Administrim Biznesi” zhvillohet në dy vite akademike dhe ka 120 kredite ECTS.</p> <p>Ky program është organizuar me lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar shpërndarjet në % për çdo kategori (Ref. H3, neni 6) dhe Tabela 9 e RVB), të cituara edhe në vijim.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, synohet arsimimi profesional dhe shkencor i studentëve në fushën “Administrim Biznesi”.</p> <p>Duke iu referuar Programit Mësimor (Tabela 10 në RVB) i cili ofron lëndë bazë të fushës së administrim-biznesit por edhe lëndë të karakterit ndërdisiplinor, mendojmë se programi i studimit siguron një përgatitje të mjaftueshme që studentët të përshtaten në tregun e punës, në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh. <i>Megjithatë, ka lëndë si Ekonometria (pjesë e modulit të metodave kërkimore) e cila nuk haset në programe të tjera të ngjashme; do të ishte më e përshtatshme të zëvendësohej me lëndë bashkëkohore të fushës së menaxhimit, si psh. “Planifikimi i Burimeve të Kompanisë” (ERP), “Lidershipi”, etj ose të ofrohej si lëndë me zgjedhje.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>

	<a href="#">RVB, Tabela 10 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Administrim Biznesi”.</a>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë nën shqyrtim ka një kurrikul e cila i mundëson studentëve të formohen me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe praktike në fushën “Administrim Biznesi”. Modulet mësimore integrojnë raste studimore për të nxitur mendimin kritik të studentëve. Megjthatë, duke qenë një master shkencor, fokusi duhet të vihet tek formimi dhe nxitja e studentëve në përdorimin e metodave të kërkimit shkencor me punime konkrete.</p> <p>Duke vlerësuar dokumentat e vëna në dispozicion për këtë program studimi, veçanërisht syllabuset e lëndëve (Aneks 2.2), mendojmë se programi ofron kryesisht literaturë bashkëkohore. Gjithashtu, bazuar në diskutimet e realizuara me institucionin dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve, si edhe vetë studentët e këtij programi, GVJ konkludon se ky program studimi përmbush objektivin e tij për të zhvilluar studentët me njohuri profesionale, të nevojshme për fushën “Administrim Biznesi”, por duhen shtuar përpjekjet për plotësimin e kopetencave lidhur me kërkimin e thelluar shkencor të studentëve, në zbatim edhe të rregullores së programit, neni 4, pika 5)</p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">2.4 Literatura e disponueshme në bibliotekën e FSHAE për DSHE.pdf</a></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf, neni 4</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar duke marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke u shprehur në planin mësimor dhe programet mësimore të lëndëve të këtij programi studimi (Aneks H3, neni 8) si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngarkesa në kredite. Mendojmë se është bërë një shpërndarje kryesisht e përshtatshme e krediteve për lëndëvet e ofruara, por ka edhe lëndë të cilat mund të kenë më pak kredite si psh. lëndët e profilit financiar; apo lëndë si psh. “Manaxhim Marketingu dhe Biznes Ndërkombëtar apo “Sjellje Organizative dhe Etika e Biznesit” të cilat mund të ofrohen të ndara ose t’i shtohet numri i krediteve për të balancuar më mirë ngarkesën e lëndës, si edhe për të bërë një diferencim me masterin tjetër shkencor që ofron njësia bazë.</li> <li>- Format e mësimdhënies janë të përshtatshme për të realizuar objektivat e lëndëve</li> <li>- Ngarkesa në auditor dhe jashtë tij kanë shpërndarje optimale</li> <li>- Lëndët e programit janë të mirë-kategorizuara</li> </ul> <p>Bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe intervistave të realizuara me grupet e ndryshme në institucion, GVJ konkludon se ky program studimi përmban elementët e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij.</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p>Referuar Aneksit H3 (neni 8), lëndët e programit të studimit MSh në “Administrim Biznesi” janë të grupuara në lëndë të detyrueshme, karakterizuese dhe ndërdisiplinore. Programi i studimit ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM Nr. 41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.5) si edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM Nr. 41 dt. 24/01/2018.</p> <p>Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive, të organizuara në semestra përgjatë dy viteve, është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kategoria A (5-10%): Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) – 10%;</li> <li>• Kategoria B (50-60%): Lëndë karakterizuese (formim specifik) –50%;</li> <li>• Kategoria C (12-20%): Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 15%;</li> <li>• Kategoria D (10%): Lëndë plotësuese (praktika profesionale, njohuri informatike, gjuhe te huaja) –10%;</li> <li>• Kategoria E (10-15%): Detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës) – 15%</li> </ul> <p><i>Gjatë intervistave me grupe të ndryshme, na u referua se praktikisht studentët bien dakort se cila prej lëndëve me zgjedhje do t’u ofrohet. Vihet re se ndër lëndët me zgjedhje janë ofruar vetëm dy dhe dy të tjerat (“E Drejtë Tregëtare” dhe “Manaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin”) asnjëherë (referuar të dhënave mbi ngarkesat e të stafit (Aneks 2.5.a,b,c dhe 6)</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">RVB, Tabela 10 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Administrim Biznesi”.</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit MSh në “Administrim Biznesi” (Aneks H 3) përcaktohen kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj. Përgatitja e diplomës kalon nëpër disa hapa, të përcaktuara në rregulloren (Aneks 5.1) dhe ka 18 kredite të cilat përbëjnë 15% të krediteve totale të programit.</p> <p><i>Ekspertët pyetën studentët për metodat e kërkimit shkencor që ata kanë aplikuar deri tani apo që po planifikojnë të përdorin për diplomat e tyre. Rezultoi se studentët kishin njohuri të limituara mbi aktivitetet kërkimore dhe nuk janë angazhuar në projekte kërkimore apo publikime shkencore, edhe pse institucioni ka një përvojë të mirë të organizimit të konferencave apo mundësisë së publikimit në revistën Optime.</i></p>

	<a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
	<a href="#">5.1 Rregullore per Mbrojtjen e Temave te Diplomave.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Albanian University është një institucion i akredituar dhe përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tij sipas ligjit në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 22, pika 1</i>). Gjithashtu, në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 22, pika 2</i>), Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit nën akreditim.</p> <p>Departamenti i Shkencave Ekonomike (DshE) është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi i cili është i organizuar në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015 - Neni 20, pika 2; Neni 22, pika 3; Neni 25, pika 1</i>).</p> <p>Të dyja njësitë e sipërpërmendura zbatojnë afatet ligjore dhe detyrimet për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si njësia kryesore e këtij programi, bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe ofron programe studimore në nivele të ndryshme (<i>L. 80/2015, Neni 23, pika 1</i>).</p> <p>Ky Fakultet përbëhet nga tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Shkencave Ekonomike</li> <li>- Departamenti i Art Disajn</li> <li>- Departamenti i Inxhinjerive</li> </ul> <p>Njësia kryesore/bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore (<i>L. 80/2015 - Neni 25, pika 4</i>), për organizimin dhe strukturën akademike. Përgjegjësitë dhe kompetencat e Departamentit ShE janë reflektuar në Rregulloren e Njësisë bazë (<i>Aneks 1.3, Kreu II, neni 9</i>), kurse organizimi i grupeve mësimore, të tilla si grup-lëndët e Menaxhimit, ato të Financë-Kontabilitetit, Ekonomiksit, Formimit Bazë, Statistikë-Matematikës, është përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregullore.</p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf, Kreu II, neni 6-9</a></p> <p><a href="#">2.1 Miratimi i kordinatorëve të grup-lëndëve.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e</p>	<p>Në njësinë bazë (Departamenti i ShE) përgjegjës për këtë program studimi, janë minimumi 7 personel akademik efektiv, ku të paktën 3 prej tyre janë me tituj/grada. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, i cili ka së</p>

<p>kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>paku gradën Doktor, përmbush detyrimet në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6). Gjithashtu përmbushet edhe detyrimi lidhur me raportin e personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar, ku së paku 70% e orëve mësimore mbulohen nga personel me kohë të plotë.</p> <p>Raportet PAE/PAK nga akreditimi i kaluar deri më sot paraqiten si vijon (bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në sistemin AMS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Viti akademik 2018-2019 (semestri I) raporti PAE/PAK = 66.8/33.2 % (Aneks <a href="#">2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf</a>)</li> <li>• Viti akademik 2018-2019 (semestri II) raporti PAE/PAK = 76/24% (Aneks <a href="#">2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf</a>)</li> <li>• Viti akademik 2019-2020 (semestri I) raporti PAE/PAK = 71.3/28.7 (Aneks <a href="#">2.5.b Ngarkesa mësimore stafi akademik 2019-2020 S.I.pdf</a>)</li> <li>• Viti akademik 2019-2020 (semestri II) raporti PAE/PAK = 73/27% (Aneks <a href="#">6. Ngarkesa mësimore 2019-2020 S.II.pdf</a>)</li> <li>• Viti akademik 2020-2021(sem I) raporti PAE/PAK = 73% / 27% (ref. <a href="#">2.5.c Ngarkesa mësimore stafi akademik 2020-2021 S.I.pdf</a>)</li> </ul> <p><a href="#">2.5.a,b,c Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">RVB, Tabela 12.(1.2.3) Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Administrim Biznesi”.</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Plani mësimor nuk ka orë laboratorike. Megjithatë, është pozitiv fakti që njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e praktikave mësimore, projekteve studimore e kërkimore, angazhon personel akademik ndihmës të cilët janë asistentja e departamentit, personeli IT, Zyra e Marrëdhënive me Jashtë, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Karrierës dhe Alumni, pjesëtarët e Bibliotekës.</p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Referuar Rregullores së Departamentit të ShE, ky program studimi nuk ka koordinatör. Përgjegjësi i Departamentit të ShE është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Departamenti ka vendosur një pedagog përgjegjës për orientimin e studentëve përse i përket praktikave profesionale.</p> <p>Referuar Strategjisë për sigurimin e cilësisë në AU, “raporti vlerësues do të hartohet nga Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti, bazuar në formatin e dërguar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të ShE i cili luan rolin e koordinatorit të programit të studimit, ngre problematikat e programit në mbledhjet e departamentit dhe përfshin analiza të përgjithshme në raportet vjetore departamentale.</p>

informacion që lidhet me programin e studimit	<p><i>GVJ, sugjeron të përfshihen edhe analiza krahasuese nga viti në vit, si edhe propozime për rritjen e cilësisë së programit apo realizimin e objektivave në të ardhmen.</i></p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf</a></p> <p><a href="#">6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në AU.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Departamenti i ShE në AU është njësi bazë mësimore-kërkimore për organizimin e programit të studimit MSh në “Administrim Biznesi”. Ai disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kurrikulat e programit të studimit;</li> <li>- Plani mësimor,</li> <li>- Syllabuset e lëndëve.</li> <li>- Rregullorja e programit, Rregullorja e Fakultetit, Rregullore e regjistrimeve, statuti, etj</li> </ul> <p>Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (<i>VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018</i>), <i>statutin</i> (Aneks 3 i dokumentave shtese), si edhe neneve 26-29 të <i>Rregullores se Fakultetit</i>.</p> <p>Kurrikula e programit është e organizuar në kategori A-E sipas <i>VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018</i>. Ajo përmban 14 lëndë, praktikën mësimore dhe diplomën, të shpërndara në 4 semestra (referuar <i>nenit 25 i Rregullores se Fakultetit, neni 4 i Rregullores se Programit</i>).</p> <p>Secila lëndë mësimore vlerësohet me numrin e krediteve përkatëse (5-8 ECTS), kurse Praktika ka 12 ECTS dhe Punimi i Diplomës 18 ECTS. Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në <i>VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018 (Pika 2.1.b)</i>. Totali i krediteve plotëson numrin total të krediteve prej 120 ECTS.</p> <p>Plani mësimor (Aneks H 3, Tabela 9) përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me <i>VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018 (Pika 2.6)</i>: emërtimi për secilin modul</p>

	<p>të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; numri i krediteve për çdo modul në ECTS; orët në total për secilin modul si dhe orët të ndara në leksion/seminar/ushtrime. Çdo modul ka detyrimet e tij (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli). Praktika ka 300 orë mësimore dhe Punimi i Diplomës 36 orë në auditor.</p> <p>Vlerësimi i dijes së studentit është 40 % gjatë vitit dhe 60 % në provimin final i cili është provim me shkrim për të gjitha lëndët. Përfundim nga mënyra e mësimorë e vlerësimit bëjnë “Praktika” dhe “Diploma”.</p> <p><a href="#">3. Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15.pdf</a></p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf</a></p> <p><a href="#">1.6 Rregullore e FSHAE.pdf</a></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Statuti i AU (neni 56 dhe 61), Rregulloret e njësisë bazë (neni 10 dhe 13), Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve (Aneks 2.3), pasqyrojnë informacionet e nevojshme në lidhje me procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit</i>). Ndërsa kriteret përfundimtare të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë të studime përcaktohen nga MASR për vitin akademik përkatës.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë takimit me stafin mësimdhënës, sekretarinë mësimore dhe studentët e programit, se institucioni nuk aplikon kriteret specifike dhe të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve dhe sidomos të atyre që vijnë nga fusha të tjera studimi, por kjo parashikohej si një objektiv për të ardhmen.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon vendosjen dhe publikimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në funksion të procedurave të përcaktuara në rregulloret e tij.</i></p> <p><a href="#">2.3 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.pdf</a></p> <p><a href="#">3. Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15.pdf</a></p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për Programin MSH në “Administrim Biznesi”, programi i lëndës që përdoret për hartimin e syllabuse-ve është modeli i përcaktuar në <i>VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2)</i>.</p> <p>Syllabuset e lëndëve të këtij program studimi janë të detajuara dhe respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve <i>VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 (Shtojca nr.2)</i>. <i>Vlen të përmendet rekomandimi për përditësimin e literaturës së 5 viteve të fundit në shqip dhe anglisht për disa syllabuse të programit. Gjithashtu, sugjerojmë të rishikohet programi i praktikës mësimore, i cili sipas</i></p>



	<p><i>syllabusit përkatës (Aneks 1.5) synon aftësimin e studentëve dhe orientimin e tyre në sektorin bankar.</i></p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">1.5 Syllabusi i lëndës praktikë mësimore.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Kurrikula e Programit MSH në “Administrim Biznes” u rishikua në Mars 2019. Gjatë vizitës në AU, mësuam se institucioni ka një praktikë të mirë për rishikimin dhe përmirësimin e syllabuseve cdo vit akademik.</p> <p><a href="#">R.3.a dhe b Përditësim i syllabuseve mësimore 2020-2021.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit ka një ngarkesë mësimore të hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, duke i shtrirë studimet në dy vite akademike, të ndarë në 4 semestra dhe të organizuar mbi bazën e lëndëve në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi (<i>VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, Pika 2.1.d</i>).</p> <p>Ngarkesa mësimore vjetore në auditor në lidhje me leksione, seminare, ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika të zhvilluara në auditor, është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>606</b> orë mësimore në auditor për vitin e I dhe</li> <li>- <b>636</b> orë mësimore në auditor për vitin II,</li> </ul> <p style="text-align: center;">ne total <b>1242</b> orë mësimore në auditor (referuar H.3)</p> <p>Ka një mospërputhje të vogël me të dhënat në RVB (tabela 10) ku ngarkesa totale rezulton 1244 orë mësimore në auditor.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>, Tabela ne fq. 7</p> <p>RVB, Tabela 10</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të Programit të studimit MSc në “Administrim Biznesi” mundësojnë thellimin e dijeve të marra nga programet bachelor, dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të subjekteve me kapital privat dhe publik duke i dhënë atyre aftësi në krijimin e sipërmarrjeve dhe menaxhimin e tyre.</p> <p>Në takimet me pedagogët e angazhuar në këtë Program studimi, u shprehën se orët e mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime) zhvillohen në formë</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit. Këto u konfirmuan edhe nga takimi me studentët e AU.</p> <p><i>Lidhur me angazhimin që kanë studentët në konferenca studentore, vlen sugjerimi i mësipërm për nxitjen e angazhimit të tyre jo vetëm në ndonjë prezantim por edhe në ndonjë punim shkencor me qëllim publikimin e tij.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>,</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe programi studimit duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, si edhe kërkimin shkencor, është në përputhje me profilin e këtij programi master shkencor.</p> <p>Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Gjithashtu, për specifikën që paraqet, tenton të mbulojë nevojat në tregun privat dhe publik të punësimit në Shqipëri dhe vendet e rajonit.</p> <p>Ngarkesa në orë mësimore në auditor prej 1242 orësh (referuar rregullores së programit, ka një laspus në RVB e cila referon në tekst 1246 dhe 1244 orë mësimore në tabelën 10) dhe me kredite prej 120 ECTS në dy vite (Aneks H.3), tregon se ky program i përmbahet përcaktimeve ligjore për këtë cikël studimi dhe e përafron atë me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Me konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione 420 ore</li> <li>- Seminare dhe ushtrime 480 ore</li> <li>- Detyra kursi 6 ore</li> <li>- Praktike mesimore 300 ore</li> <li>- Tema e diplomes 36 ore</li> </ul> <p>Raporti Teori –Praktikë: <b>456</b> (420+36) /<b>786</b> (480+6+300) ose afërsisht <b>1/1.7</b></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>, fq.7</p> <p><a href="#">RVB, Tabela 10</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi (Aneks 2.2) përmbajnë formatin dhe elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 (Shtojca nr.2).</p> <p>Gjatë takimeve me anëtarët e GVB-së dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, ashtu si edhe shprehet në RVB, na u referua se syllabuset përditësohen çdo vit akademik.</p>

	<p>GVJ, konstaton nga kontrolli i syllabuseve, se ka module që kanë nevojë të përditësojnë literaturën bazë dhe rekomanduese, duke qenë se shkon përtej harkut kohor të 5 viteve të fundit.</p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">R.3.a Përditësimi i syllabuseve mesimore 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">R.3.b Përditësim i syllabuseve mesimore 2020-2021.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” ka si fokus marrjen e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet për formimin e shprehive të veçanta në këtë fushë. Studentët fitojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve, funksionet e marketingut, financës, marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>,</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> <p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulave mesimore me aftësitë që kërkon tregu i punës. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë.</p> <p>Drejtuesit e njësisë dhe pedagogët shprehën se kanë kryer studim tregu i cili ka patur si qëllim të identifikojë se cilat janë njohuritë, aftësitë apo kompetencat që kërkojnë bizneset nga ekspertët e rinj apo nga studentët e diplomuar, si punonjës potencial në tregun e punës.</p> <p><a href="#">Aneks 1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf</a></p> <p>Programi MSH “Administrim Biznesi”, si program studimi i ciklit të dytë, synon të kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme profesionale dhe shkencore për të ndjekur trajnime të tjera të thelluara profesionale apo dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve. Edhe pse programi përfshin në kurrikulën e tij organizimin e lëndëve të tilla si “Metodat e Kërkimit Shkencor dhe Ekonometri”, <i>takimi me studentët dëshmoi se ata kanë njohuri dhe aftësi të limituara për kërkime e analiza shkencore.</i></p> <p><i>Rekomandohet thellimi i studentëve me projekte konkrete në fushën e metodave kërkimore, për të nxitur përgatitjen e tyre për të avancuar në studime shkencore më të avancuara, si psh studimet në doktoratë.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit**

**për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**

**Kriteret Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Sipas informacionit në RVB, rezulton se të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik:

- **2018-2019**, janë angazhuar 10 personel akademik nga të cilët **6 PAE** dhe **4 PAK**, të gjithë me grada dhe tituj shkencor;
- **2019-2020** në këtë program studimi janë angazhuar **9** personel akademik nga të cilët **5 PAE** (nga të cilët 1 Dr. Proc.) dhe **4 PAK** (nga të cilët 1 Dr. Proc).
- **2020-2021** (sem. I), janë të përfshirë në këtë program studimi **5** personel akademik PAE (nga të cilët 1 Dr. Proc.) dhe 4 PAK (nga të cilët 1 Dr. Proc).

Ndërsa, bazuar në të dhënat e tabelave të vëna në dispozicion nga institucioni (referencat e mëposhtme), rezulton se të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik **2018-2021 (sem I)** janë si vijon:

Stafi akademik në Programin e studimit dhe Kualifikimi	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof		1				1
Prof As	3	1	2	2	1	2
Dr.PhD	3	2	3	2	4	
Msc (Dr proc)						
<b>Totale</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>3</b>

GVJ evidenton se *ka një mospërputhje* përse i përket informacionit të mësipërm të cituar në RVB mbi gradat shkencore (Msc-Dr. Proc) i cili bie ndesh me kërkesat ligjore (*Ligji 80/2015 - Neni 59, pika 6.* ) sipas të cilit personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi duhet të ketë një gradë më lartë se sa cikli i studimit ku japin mësim, me tabelën e mësipërme përpiluar nga GVJ pas verifikimit sipas listës së personelit akademik të programit të studimit (paraqitur në tabelat e anekseve 2.5.a,b,c dhe 6) dhe takimit me zyrën e burimeve njerëzore.

Rrjedhimisht, AU përmbush pjesërisht kërkesat ligjore në fuqi lidhur me personelin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit.

[2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf](#)

[2.5.b Ngarkesa mësimore stafi akademik 2019-2020 S.I.pdf](#)

[2.5.c Ngarkesa mësimore stafi akademik 2020-2021 S.I.pdf](#)

[6. Ngarkesa mësimore 2019-2020 S.II.pdf](#)

**Kriteri 3.** Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe

Për fushën akademike-kërkimore të anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përgjithësisht, kanë bërë

<p>specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>përpjekje të jenë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim.</p> <p>Megjithatë, nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik të këtij programi, gjatë vizitës në institucion, vihet re se ka ndonjë mospërputhje (Ref. R.1) midis edukimit/ fushave të specializimit dhe moduleve që mbulojnë.</p> <p><i>Rekomandohet të nxitet më tepër angazhimi i personelit për të zhvilluar specializime në fusha studimi që mund të përkojnë me fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit.</i></p> <p><a href="#">2.6 CV e stafit Akademik, programet MSc.pdf</a></p> <p><a href="#">R.1.e Lista e stafit akademik, ngarkesa dhe fusha e studimit.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së programit rezultoi se studentët gjatë semestrit të 2-të të vitit të 2-të, zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës. Institucioni disponon një listë bashkëpunimesh (tabela 5 në RVB) për të ndihmuar studentët në kryerjen e praktikave profesionale. Megjithatë shumica e studentëve kryejnë praktikën pranë institucioneve ku punojnë, zgjidhje kjo e përshtatshme duke konsideruar kushtet e diktuar nga pandemia botërore.</p> <p>Per punimin e diplomës si rregull, studenti supervizohet nga pedagogu udhëheqës gjatë periudhës së zhvillimit të punimit të diplomës, por ky proces do të fillojë semestrin e dytë. Megjithatë, nga komunikimi me studentët gjatë vizitës në institucion, rezultoi se ata janë në komunikim të vazhdueshëm me pedagogët e tyre përmes platformës elektronike, për çdo problematikë që mund të hasin gjatë procesit mësimor në këtë program.</p> <p><a href="#">2.7 Emërtimet e temave të diplomës MSc 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">3.10 Formati i vlerësimit të temës së diplomës.pdf</a></p> <p><a href="#">5.1 Rregullore për Mbrojtjen e Temave të Diplomave.pdf</a></p> <p><a href="#">5.1 Kërkesë për Temë Diplome të Studentit.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Programi mësimor nuk parashikon orë laboratorike. megjithatë, studentët e këtij programi realizojnë orët laboratorike të lëndës “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, në lab e informatikës ku është instaluar edhe programi Financa 5, program i cili i vjen në ndihmë edhe për lëndët e financës.</p> <p>Profesori i informatikës kujdeset edhe për mirëmbajtjen e laboratorit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi II.6**

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas RVB-së dhe diskutimeve gjatë vizitave në AU, strukturat përgjegjëse të studimit kryejnë përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut bazuar në eksperiencën e vet pedagogëve të angazhuar në program të cilët punojnë në biznese, insitucione bankare apo administratë, si edhe opinionin dhe eksperiencën e studentëve të cilët janë përgjithësisht të punësuar.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të mos ngelet vetëm në nivelin e eksperiencës së pedagogëve, por të rrisë bashkëpunimin me aktorë të tjerë nga tregu i punës të cilët mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me aftësitë e kërkuara nga tregu i punës, duke përdorur një metodologji të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, dhe konsiderojë propozimet e tyre, duke e mbështetur në evidence implementimin e sugjerimeve të tyre.</i></p> <p><a href="#">1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>AU shprehet në RVB dhe dokumenta të tjera si rregulloret e institucionit dhe programit (referuar gjithashtu procesverbalit të mbledhjeve departamentale në Aneksin 3.6), apo përmes pyetësorëve të studentëve, se i përfshin ata në përmirësimin e programit të studimit. Rats konkret është futja e programit “Financa 5”.</p> <p><a href="#">3.6 Mbledhje departamenti.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Në AU, Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte dhe informon studentët.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>DShE ka aplikuar për hapjen e programeve të reja të studimit në nivel master profesional, sipas kërkesave të tregut.</p> <p>Gjithashtu është aplikuar edhe për programin e studimit Doktoratë në “Ekonomik dhe Zhvillim i Qëndrueshëm”.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi II.7****Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>RVB thekson se Institucioni impenjohet për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të tij në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktit shoqëror.</p> <p>GVJ vlerëson, nga shqyrtimi i dokumentave strategjikë të AU, (<i>Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit, Departamentit dhe Programit</i>) dhe nga vizita në institucion, se programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” është në përputhje e në zbatim të planit strategjik dhe objektivave madhorë të institucionit, në kuadër të strategjisë afatgjatë të zhvillimit të AU, të tilla si: procesin e mësimdhënies/ mësimnxënies, kërkimin shkencor, bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar, studentët, etj.</p> <p><a href="#">3. Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15.pdf</a></p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf</a></p> <p><a href="#">1.6 Rregullore e FSHAE.pdf</a></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik, por edhe nga shqyrtimi i dosjeve të tyre, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka në dispozicion disa instrumenta nxitës të tillë si mundësi për të kërkuar mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve shkencore, mundësi për publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore falas në revistën OPTIME, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> <p><i>Megjithatë, puna kërkimore dhe botimet që lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi, janë ende të limituara.</i></p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf, neni 16</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Programi përmban lëndë të tilla si “Metodat e Kërkimit Shkencor dhe Ekonometri”, të cilat aftësojnë studentët me njohuri për t’u angazhuar në projekte kërkimore apo konferenca shkencore, por siç e përmendëm edhe më lart studentët e këtij programi nuk janë angazhuar në aktivitete të tilla të cilat të kenë përfunduar në një punim shkencor dhe botim, duke ngelur në nivelin e detyrave të kursit.</p> <p><i>GVJ rekomandon rritjen e përfshirjes së institucionit në projekte rajonale dhe kombëtare, për të ofruar më tepër mundësi integrimi të studentëve në projekte kërkimore shkencore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron</p>	<p>AU tregon gatishmëri për të mbështetur financiarisht stafin akademik për aktivitete kërkimore shkencore. Gjithashtu, AU mbështet publikimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik efektiv dhe me kontratë nëpërmjet revistës OPTIME.</p>

të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	<i>GVJ rekomandon që Institucioni të hartojë një fond të veçantë në buxhet për aktivitete kërkimore si edhe të hartojë dhe shpallë kritere për aplikimin e një politike financimi në mënyrë të barabartë të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MSHAB.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.8

**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>AU ka organizuar dhe bën përpjekje vazhdimisht për të mbështetur përfshirjen e stafit akademik në disa trajnime apo konferenca shkencore lokale, p.sh në Shkurt pritet të organizohet një konferencë studentore në bashkëpunim me Universitetin e Korçës (referuar takimit me Zyrën e Kërkimit Shkencor). Megjithatë numri i këtyre aktiviteteve është i vogël.</p> <p><i>GVJ rekomandon angazhimin e institucionit në rritjen e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në kuadër të kërkimit shkencor, si edhe krijimin e grupeve apo shtylla kërkimore, nga të cilat, të mund të përfitojnë edhe programet e masterave shkencorë për realizimin e objektivave të tyre në kërkimin shkencor.</i></p> <p><a href="#">3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare, 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">5.5 Aktivitet shkencor, Konferenca Dhjetor 2018.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Institucioni ka një eksperiencë të mirë në organizimin e konferencave (Aneks 3.8), përveç vitit të fundit për shkak të pandemisë.</p> <p>Gjatë takimit me Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve akademike na u referua se ka pasur interes për bashkëpunim nga institucione shtetërore si Parlamenti Shqiptar, Arkiva e Shtetit, KLSH. Kjo zyrë në bashkëpunim me departamentet përkatëse është përgjegjëse të angazhoje personelin akademik lidhur me kërkesat për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor. Ka pasur përpjekje të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për projekte dhe botime të karakterit kërkimor-shkencor, megjithatë <i>GVJ konstaton se kërkimi shkencor dhe publikimet e stafit të këtij programi, janë të pakta gjatë dy viteve të fundit. Ndërkohë, për studentët, nuk ka evidenca publikimi, përveç pjesëmarrjeve me prezantim në një konferencë të organizuar nga institucioni.</i></p> <p><i>Gjithashtu, institucioni nuk disponon një procedurë transparente për alokimin e fondeve në kuadër të kërkimit shkencor.</i></p>



	<p>Sikurse përmendur edhe më sipër, <i>GVJ</i>, rekomandon që këto bashkëpunime të rriten në numër dhe institucioni të hartojë dhe shpallë kritere për aplikimin e një politike financimi në mënyrë të barabartë të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MShAB.</p> <p><a href="#">3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare, 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">5.5 Aktivitet shkencor, Konferenca Dhjetor 2018.pdf</a></p> <p><a href="#">3.8 Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore DSHE 2020-2021.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	<p>Mjeti kryesor që përdor institucioni si udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme mësimorë është formati i syllabus siç jepet në Evidencën 3.1. Ky format përcakton temat e lëndës të organizuara në leksione, seminare dhe ushtrime, literaturën përkatëse si dhe orët për secilën.</p> <p>Kriteret e frekuentimit dhe kontrollit të vazhdueshëm janë gjithashtu përcaktuar qartë në syllabus ku pjesën kryesore e ka provimi përfundimtar me 60%. Kjo duket në përputhje me udhëzimet me MASR dhe ligjet në fuqi.</p> <p>Për sa i përket nxitjes së metodave inovative, ato realizohen kryesisht nëpërmjet aktivizimit në klasë nëpërmjet aktiviteteve që i ka në dorë vetë pedagogu të lidhura edhe me 20% të vlerësimit për çdo lëndë.</p> <p><a href="#">3.1 Format syllabusi, v.a 2020 - 2021.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të	Institucioni ka të ngritura një sërë strukturash për monitorimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik si Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave [Evidence 1.4, Neni 14, 16, fq. 16 - 18] dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin [Evidence 1.4, Neni 15, fq. 18].

<p>personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Ndërkohë Drejtuesi i Departamentit ka përgjegjësinë të vlerësojë kapacitetet e stafit akademik në nivel mësimdhënieje dhe aktivitet kërkimor në bazë të rregulloreve të institucionit dhe fakultetit.</p> <p><a href="#">1.3 Rregullore e DShE.pdf</a></p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p> <p><a href="#">1.6 Rregullore e FSHAE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni organizon në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve vlerësimin e stafit administrative dhe akademik duke përdorur një pyetësor online nëpërmjet Google Forms.</p> <p>Në vend të Evidencës R5a dhe R5b ku listohen pyetjet e vlerësimit do ishte më me vlerë të jepeshin përgjigjet e këtyre pyetjeve në mënyrë të përmbledhur për të bërë një vlerësim të saktë të ecurisë.</p> <p><i>GVJ sugjeron përpilimin e raporteve analitike dhe krahasuese me rezultatet e pyetësorëve, të shoqëruara me propozime apo masa për përmirësime në të ardhmen.</i></p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC, Departamenti dhe Senati Akademik bëjnë vlerësimin dhe komunikimin e rezultateve të vlerësimit të pedagogëve duke menaxhuar gjithë procesin. Këto vlerësime komunikohen në mënyrë individuale për të ruajtur konfidencialitetin.</p> <p><a href="#">6.3.b Sigurimi i Cilësisë në Nivel departamenti, 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">6.3.c Sigurimi i Cilësisë në Nivel Departamenti, 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në AU.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Analiza e pyetësorëve në nivel Universiteti dhe njësi bazë ka qëllim të promovojë praktikave të mira dhe të nxisë vazhdimësinë e tyre. Për një gjë të tillë përgjegjës është kryesisht departamenti dhe drejtuesit akademikë të programit të cilët mbikëqyrin kërkesat që pedagogët bëjnë për përditësimin e syllabus, materialeve dhe ndryshime të tjera që të jenë në përputhje me kërkesat e studentëve dhe të tregut.</p> <p><i>Praktika standarde stimulimi dhe vlerësimi për pedagogë e staf të dalluar në mësimdhënie, kërkim ose fusha të tjera nuk ka, por institucioni po e konsideron një gjë të tillë për të ardhmen.</i></p> <p><a href="#">5.1 Informacion mbi pyetesoret.pdf</a></p> <p><a href="#">5.2 Rezultatet - pyetesor studente 19-20.pdf</a></p> <p><a href="#">5.3. Rezultatet pyetesor personel akademik 19-20.pdf</a></p> <p><a href="#">5.4 Rezultatet pyetesor stafi adm 19-20.pdf</a></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në bazë të rregullores së institucionit në evidencën H3, Tabelës 13 në RVB dhe syllabus siç jepet në Evidencën 3.1, formati kryesor i mësimdhënies përfshin sa më poshtë në orë auditori:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione 420 orë mësimore</li> <li>- Seminare 182 orë mësimore</li> <li>- Ushtrime 300 orë mësimore</li> <li>- Detyra kursi 6 orë mësimore</li> <li>- Praktikë profesionale 300 orë mësimore</li> <li>- Diploma 36 orë mësimore</li> </ul> <p>Strukturara e lëndëve të programit duket e standardizuar në peshë leksionesh, seminaresh e provimesh.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">3.1 Format syllabusi, v.a 2020 - 2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Në RVB thuhet se stafi akademik është i hapur në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Në raportin e departamentit dhe takimet e zhvilluara në AU evidentohet një gjë e tillë në praktikë.</p> <p>Praktika që ndiqet për të analizuar çfarë sugjerimesh dhe kërkesash janë marrë nga studentët, si janë zbatuar dhe ndjekur ato, dhe çfarë praktikash të tjera janë përshtatur me nevojat e studentëve për secilën lëndë të programit <i>mund të specifikohet më mirë në rregullore.</i></p> <p>Fakti që studentët kanë mundësi të ndjekin praktika mësimore pranë kompanive është pozitiv megjithëse, duke qenë të punësuar gjatë kohës së studimeve, studentët mund t'i ndjekin praktikat pranë kompanive të tyre.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme</p>	<p>Përshtatja e syllabus-eve (Evidence 3.1) në përputhje me udhëzimet e MASR dhe ligjet në fuqi konfirmohet. Pedagogët përfshijnë metoda të ndryshme si raste studimore, punë në grup, diskutime e prezantime përveç leksioneve.</p>

<p>dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Për sa i përket trajnimeve të NJSBC për zhvillimin e stafit në drejtim të përmirësimit të metodave didaktike, temat e këtyre trajnimeve të dhënë në Evidencën 3.5 duken me rëndësi në drejtim të përmbushjes së këtij kriteri. Ato kanë të bëjnë me vlerësimin psikosocial, motivimin e studentëve, shkëmbimin e eksperiencave dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.</p> <p><i>GVJ sugjeron përkthimin e këtyre aktiviteteve në raporte të cilat të analizojnë sa anëtarë stafi marrin pjesë në këto trajnime në përgjithësi dhe nga MSh. AB në shqyrtim, dhe sa efektive kanë qenë këto trajnime në rezultatet e pritura.</i></p> <p><a href="#">3.1 Format syllabusi, v.a 2020 - 2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Kompetenca e stafit akademik për mësimdhënie jepet e mirëqene. Shpjegohet se stafi akademik angazhohet në nxitjet e studentëve dhe mësimdhënien nëpërmjet detyrave të kursit dhe aktiviteteve për çdo lëndë.</p> <p>AU, nëpërmjet NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të mësimdhënies, çdo vit akademik.</p> <p><a href="#">CV-të e personelit akademik</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Konfirmohet se institucioni është në vlerësim të vazhdueshëm të formave mësimore dhe përmirësimit të tyre në bazë të, kryesisht, vlerësimeve që vijnë nga vetë studentët. Përditësimi i anës shkencore nga ana tjetër bëhet nga pedagogët nën mbikëqyrjen e departamentit dhe drejtueses së programit.</p> <p>Kriteri i përditësimit të syllabuseve dhe materialeve në masën 20% ose më tepër ndërmjet këtij vlerësimi dhe atij të mëparshëm duket në përgjithësi i plotësuar, sidomos në lëndë që kanë lidhje me etikën e biznesit, marketingun ose burimet njerëzore. Këto ndryshime bëhen nga pedagogët duke marrë parasysh edhe vlerësimet e studentëve në një proces të mbikëqyrur nga departamenti.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Në nivel shkencor dhe didaktik, institucioni nxit mësimdhënien interaktive duke i dedikuar 20% të vlerësimit aktivizimit në klasë për çdo lëndë. Për shembull, një metodë interaktive angazhimi është diskutimi i rasteve studimore.</p> <p>Ana praktike e lëndëve është diçka pozitive që ka lidhje me tregun e punës dhe lidhjeve të thelluara të pedagogëve në të.</p> <p>Përqendrimi në faktorë financiarë në këtë program studimi mund të zgjerohet për të kualifikuar menaxherë biznesi të zotë dhe që i shërbejnë vendit në shumë drejtime, përfshirë edhe ato sociale, jo vetëm ekonomike dhe financiare.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë</p>	<p>Është e rëndësishme dhe pozitive që nëpërmjet seminareve dhe praktikave mësimore studentëve ju jepet mundësia të mësojnë duke praktikuar dijet që marrin.</p>

<p>udhëzimin dhe mbështetjen nga mësime të mësimdhënies dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Institucioni ka marrëdhënie institucionale me 25 organizata për praktika mësimore siç tregohet në Tabelën 5 për të bërë të mundur një gjë të tillë.</p> <p>Pedagogët e çdo lënde duhet të sigurohen që pavarësia dhe mësimi i studentëve nuk kufizohet vetëm në anën praktike, po dhe në anën konceptuale.</p> <p><i>Për këtë duhet më tepër evidencë në lidhje me metodat e nxitjes së debatit, diskutimit dhe mendimit ndryshe në klasa, sa të hapur janë pedagogët e lëndëve për të pranuar mendime ose përgjigje alternative nga studentët.</i></p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf tabela 5</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësime të mësimdhënies, mësime të mësimdhënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Vendndodhja e institucionit ku kryhet edhe mësime të mësimdhënies për këtë program MSh AB është shumë e mirë dhe pranë qendrës së Tiranës. Ambientet janë moderne, të mëdha dhe me kushte optimale mësime të mësimdhënies për sa i përket sallave të leksioneve, seminareve, dhe infrastrukturës mbështetëse në to.</p> <p>Këto ambiente janë të pastra, me dritë të mjaftueshme dhe mirëmbahen duke patur para sysh edhe rregullat e Covid-19 në këtë kohë.</p> <p><a href="#">4.3 Planimetrite.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambientet mësimore për këtë program MSh AB janë funksionale dhe të pajisura me gjithë logjistikën e nevojshme për kryerjen e mësimit me projektor, internet pajisje kompjuterike.</p> <p><a href="#">4.3 Planimetrite.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Nga vizita u vu re se baza kompjuterike me pajisje dhe internet është e mirë.</p> <p>Institucioni i është përgjigjur kërkesave të studentët për programe si Finance 5. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i SPSS ose softëare të ngjashëm për analiza sasiore duhet nxitur. Përmenden dhe programe CRM që kanë lidhje drejtpërdrejt me administrimin e bizneseve.</p> <p><i>Mund të konsiderohet në të ardhmen më shumë infrastrukturë me programe kompjuterike më të specializuara edhe për kërkime cilësore, ose simulime biznesi për edukim.</i></p>

	<p>Masat që institucioni ka marrë për zhvillimin e mësimin nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe gjatë periudhës së Covid-19 janë të kënaqshme.</p> <p><a href="#">Nga takimet me studentët, drejtuesit dhe pedagogët</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Fakti që biblioteka ofron rreth 246 tekste në fushën e ekonomisë që supozon përfshin edhe menaxhimin, aksesin në 83,000 libra dhe 10 milion artikuj shkencorë nëpërmjet Questia dhe librarive të tjera online është pozitiv. (regjistrimi me Questia ishte në periudhë negociimi).</p> <p><i>Ndërkohë në bibliotekë mungojnë disa libra kryesorë lëndësh si Sjellje Organizative, Menaxhim Marketingu e Menaxhim Projektsh.</i></p> <p>Është i rëndësishëm fakti që pedagogët e lëndës sugjerojnë në mënyrë specifike literaturën mbështetëse për çdo lëndë dhe temë në syllabus.</p> <p>Për përditësime të këtyre materialeve bëhet kërkesë në bibliotekë që të merren dhe të vihen në dispozicion të studentëve materialet.</p> <p><a href="#">R.4 Kërkesë për pasurimin e bibliotekës 2020-2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni ka një bibliotekë e cila është e hapur nga e hëna në të premte 8:00 – 16:00 dhe të shtunën 8:00 – 12:00. Ky orar mund të jetë i papërshtatshëm për studentët që punojnë paradite, por për shkak të Covid-19 dhe mundësive të shumta online për akses materiale, nuk përbën një problem të madh.</p> <p>Institucioni, sipas RVB, ofron 246 tituj librash në fushën e ekonomisë, akses në disa dhjetëra mijëra artikuj shkencorë, dhe materialet e kërkuara nga çdo lëndë dhe temë përkatëse për MSh. AB, të përditësuara sipas nevojave.</p> <p>Për momentin nuk u vu re shtim kapacitetesh me kompjutera të rinj në bibliotekë.</p> <p><a href="#">2.4 Literatura e disponueshme në bibliotekën e FSHAE për DSHE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Fakti që biblioteka ofron rreth 246 tekste në fushën e ekonomisë që supozon përfshin edhe menaxhimin, aksesin në 83,000 libra dhe 10 milion artikuj shkencorë nëpërmjet Questia dhe librarive të tjera online është pozitiv. <i>Megjithatë, ky akses jepet nga të dhëna logimi qendrore dhe jo te personifikuar për çdo student.</i></p> <p><i>Duhet patur kujdes me faqe si <a href="https://z-lib.org/">https://z-lib.org/</a> të përmendura në RBV për plotësimin e këtij kriteri dhe nëse ato respektojnë të drejtat e autorëve dhe botuesve për artikujt shkencorë që ofrojnë falas.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita u vu re se institucioni vë në dispozicion Laboratorin e Informatikës me kapacitet 25 kompjutera për lëndët Informatikë, Menaxhim i Sistemeve të Informacionit, Statistike dhe Kontabilitet Financiar, të pajisur me Microsoft Office the Finance 5. Ky laborator mund të përdoret edhe për punimin e diplomave.</p> <p>Ambientet e bibliotekës përdoren nga studentët edhe për punimin e detyrave në laptopët personalë duke rritur efikasitetin e përdorimit të ambienteve në mënyra më multifunksionale.</p>

<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga vizita u tregua për përdorimin e Microsoft Team gjatë vitit të fundit për mësimin online është pozitiv. Microsoft Teams është një nga platformat më të mira dhe profesionale në treg për video-konferenca dhe për të vënë në dispozicion materiale mësimore për grupe studentësh.			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Në RBV përmenden përdorimi i emailit dhe platformave të edukimit online (pa specifikuar cila) për plotësimin e këtij kriteri. Institucioni ka integruar Google Classroom dhe Microsoft Teams në procesin mësimor. <i>Do ishte me vlerë dhe të shikohej mundësia e Moodle (open source) ose Blackboard a Canvas për një menaxhim më të mirë të materialit të lëndëve në mënyrë të integruar me sekretarinë mësimore.</i> <a href="#">Aneks RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Departamenti vë në dispozicion një sërë temash për studentët e diplomës, cakton një udhëheqës teme që mbështet studentin gjate temës, organizon seminare udhëzuese brenda 12 javëve dhe ofron infrastrukturë mbështetëse për sa i përket literaturës dhe bazës informatike për diplomat. <a href="#">Aneks H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka dy njësi përgjegjëse për promovimin e përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies. Ato janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave [Evidencë 1.4, Neni 14, 16, fq. 16 - 18], si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin [Evidence 1.4, Neni 15, fq. 18].  Në bazë të pyetësorëve të vlerësimit nga studentët dhe punës së Drejtuesit të Departamentit bëhet i mundur koordinimi në nivel qendror dhe specifik për programin.  <a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik	Njësia qendrore bazë për MSh AB është Departamenti i Shkencave Ekonomike në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Albanian University.  Kontrolli kryhet nëpërmjet mbledhjeve të departamentit siç tregohet në Evidencën 3.6.

<p>dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p><a href="#">Aneks 3.6 Mbledhje departamenti.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Disa metoda eksperimentale të përmendura në RVB për të ilustruar plotësimin e këtij kriteri janë përdorimi i Google Classroom. Ndërkohë trajnime të organizuara nga NJSBC nxisin përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe teknologjive të informacionit. Për shembull, në përgjigje të nevojave për mësimdhënie online, institucioni dhe ky program ka implementuar me sukses përdorimin e Microsoft Teams për mësimdhënie interaktive dhe për ruajtjen dhe vënien në dispozicion të materialeve mësimore studentëve.</p> <p>Evidenca e dhënë në RVB i referohet trajnimit të stafit akademik për përdorimin e teknologjive të informacionit çka u testua në 2019-2020 në zhvillimin e mësimdhënies online.</p> <p>Siç përmendet edhe më lart, <i>Institucioni mund të bëjë më shumë në drejtim të kualifikimit të vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor që ndikon në përmirësimin e mësimdhënies.</i></p> <p>Një proces i tillë mbikëqyret nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin. Kjo duhej të ishte evidentuar dhe shprehur qartë nga vetë institucioni në RVB.</p> <p>Plotësimi i këtyre kriterëve evidentohet nga trajnimet e ofruara çdo fillim viti nga NJSBC për stafin akademik. Këto trajnime nuk duhet të kufizohen vetëm kryesisht tek stafi i ri i rekrutuar.</p> <p>Njëkohësisht, përveç axhendës së trajnimeve (të dhëna në Evidencën 3.5) <i>GVJ rekomandon të paraqitet dhe një informacion më i saktë sa pedagogë marrin pjesë në secilin trajnim, dhe të analizohet nëse rezultatet e atyre që marrin pjesë rezultojnë më të larta në mësimdhënie në krahasim me ata që nuk marrin pjesë në trajnime.</i></p> <p><a href="#">3.5.a Axhenda e trajnimeve 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">3.5.b Axhenda e trajnimeve 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">6.3.c Sigurimi i Cilësisë në Nivel Departamenti, 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në AU.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Rregullorja e institucionit, fakultetit dhe departamentit përcaktojnë qartë përgjegjësinë e stafit akademik për zbatimin e programit të studimit sipas syllabus-eve të miratuara.</p> <p><i>Angazhimi për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja kërkon një ndërveprim më të mirë nga lart-poshtë nëpërmjet Njësive së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, por edhe nga poshtë-lart duke nxitur më tepër nismat e vetë pedagogëve.</i></p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p>



	<a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	<p>Evidenca R.5.a.b. i referohet raportit vjetor të Departamentit të Shkencave Ekonomike. Në të është vështirë të gjendet evidencë specifike e plotësisht të këtij kriteri. Po ashtu evidence 3.8 i referohet Planit të Aktiviteve Kërkimore Shkencore.</p> <p>Një evidencë në lidhje me angazhimin e lektorëve dhe kërkuesve shkencorë me institucione partnere për qëllime shkëmbimi idesh, metoda të mësimdhënies dhe kërkim shkencor jepet në CV-të e stafit akademik.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Sipas evidencës 2.2 për syllabuset e lëndëve të MSh AB tregohet qartë se vlerësimi i studentëve bëhet në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- provimit përfundimtar (60%),</li> <li>- provimit të ndërmjetëm (20%) dhe</li> <li>- pjesëmarrjes aktive (20%).</li> </ul> <p>Përveçse në syllabuset përkatëse kur regjistrohen për programin MSh AB, studentët njihen me mënyrat e vlerësimit sa më sipër dhe në fillimin e çdo lënde.</p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Specifikimet e çdo lënde përkatëse jepen nëpërmjet syllabuseve sipas evidencës 2.2 specifikisht për programin MSh AB.</p> <p>Aty studentet informohen për përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit kur regjistrohen dhe në fillim të çdo lënde.</p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë	<p>Sipas Evidencës H3 Rregullorja e MSh AB paraqiten qartë lëndët dhe njohuritë që marrin studentët nga ky program. Gjithsesi, provimi përfundimtar 60% mbetet mënyra kryesore dhe standarde e vlerësimit për gati të gjitha lëndët. <i>Kjo nuk përmbush në nivel të kënaqshëm këtë kriter, për sa i përket formave dhe mënyrave</i></p>

mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	të ndryshme të vlerësimit, megjithë komponentët e tjerë 20% për pjesëmarrje dhe 20% për provime të ndërmjetme. <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.6

#### Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Testimi i njohurive kryhet gjatë gjithë vitit në lëndë të ndryshme dhe nga komponenti 20% i vlerësimit për pjesëmarrjen.  Megjithëse kjo përqindje është e ulët në krahasim me peshën e provimeve, konsiderohet se është e kënaqshme për të inkurajuar studentët të mbeten të angazhuar.  <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni ka integruar sisteme teknologjike informacioni që eliminojnë forma të ndryshme abuzimi nëpërmjet barcodeve për sekretimin e fletëve të provimit.  <i>Mund të konsiderohet në rregulloren e MSh AB të paraqitur si evidencë (H3 kreu IV) edhe sekretimi i llojeve të tjera të vlerësimit</i>  <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në sallën e provimit përfundimtar janë prezent praktikisht pedagogu i lëndës dhe një pedagog ose asistent tjetër, mbështetur kjo dhe nga rregullorja e MSh AB (Evidenca H3).  <i>Përfshirja e dy pedagogëve ku njëri është titullari i lëndës duhet të shtrihet edhe përtej monitorimit të procesit të provimit.</i>  Duhet të jepet evidencë e qartë në përfshirjen e dy ose më tepër pedagogëve përfshirë titullarin e lëndës në hartimin e provimeve dhe mënyrave të vlerësimit gjatë gjithë vitit, në vënien e notave nga vetë ata, dhe procesi që ndiqet për rakordimin e notave nga të paktën dy pedagogë dhe jo vetëm titullari i lëndës ose një pedagog tjetër.  <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Procesi që ndiqet për provimet me shkrim kryhet nëpërmjet sekretimit të fletëve të provimit gjatë vlerësimit. Kjo menaxhohet nga sekretaria mësimore që i komunikon studentit notën.  <i>Për komponentin tjetër prej 20-40% të notës në bazë të pjesëmarrjes dhe një detyrë dytësore nuk ka evidencë që ruhet anonimiteti sipas rregullores e MSh AB të paraqitur si evidencë (H3 kreu IV). Gjithashtu, nuk shpjegohet si ruhet</i>

<p>monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p><i>anonimiteti ose vlerësimi i drejtë i provimeve ose detyrave të kursit të tjera ose jo me shkrim.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas rregullores së institucionit (Evidenca 1.4) dhe syllabus për lëndët e MSh AB studenti testohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 60% provimi përfundimtar</li> <li>• 20% provimi i ndërmjetëm</li> <li>• 20% aktivizim</li> </ul> <p>Vetëm për komponentin e fundit, 20% aktivizim gjatë klasave të aktiviteteve mësimore studenti shprehimisht pritet të marrë komente që justifikojnë vlerësimin dhe mbarëvajtjen, por edhe komponentët e tjerë (provimet) nuk e përjashtojnë mundësinë e marrjes së komenteve.</p> <p>Megjithatë nuk ka evidencë që notat e provimeve (80%) shoqërohen me komente që të justifikojnë notat, por studentët mund të kërkojnë të shohin tezën dhe vlerësimin për më tepër informacion.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Pjesa e parë e përgjigjes ndaj këtij kriteri në RVB i referohet masave për të shmangur plagjiaturën nga studenti, ndërkohë që kriteri i referohet stafit akademik.</p> <p>Kontrollet që pedagogët e lëndës dhe departamenti bëjnë për detyrat e kursit në databazën e institucionit janë një hap para në këtë drejtim, por ky hap mbetet shumë i kufizuar në krahasim me mundësitë e abuzimit me plagjiaturë nga jashtë institucionit.</p> <p><i>GVJ sugjeron implementimin e provimeve ku edhe me libër ose materiale hapur të behet i mundur vlerësimi i saktë i studentëve për sa i përket të menduarit kritik origjinal për diskutimin dhe aplikimin e njohurive të administrimit të biznesit.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i provimeve bëhet nën mbikëqyrjen e titullarit të lëndës brenda 7 ditëve. Ky vlerësim kombinohet me vlerësimin për provimin e ndërmjetëm dhe pjesëmarrjen, dhe i komunikohet studentit nga sekretaria mësimore.</p> <p>Nuk jepen të dhëna në dhe rregulloren e MSh AB të paraqitur si evidencë (H3 kreu IV) nëse titullari i lëndës duhet të konsultohet me kolegë për kalibrimin e tezave të pyetjeve të vlerësimit, nëse vlerësimi i provimeve rakordohet dhe kontrollohet në mënyrë të organizuar nga më tepër se një pedagog ku ata mbikëqyrin njëri-tjetrin, dhe nëse ka pyetje model ose jo të përgatitura paraprakisht para provimeve që të mund të krahasohet nëse vlerësimi i pedagogut ka qenë korrekt sipas këtyre përgjigjeve model ose subjektiv. Një gjë e tillë ju lihet në dorë dy pedagogëve që firmosin procesverbalin e vlerësimit, ndërkohë që</p>

	<i>institucioni mund të ndërmarrë hapa konkretë për standardizimin e praktikave të vlerësimit kolegjal.</i> <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas Nenit 24 pika 3 të rregullores se MSh AB studentët kanë të drejtë të shikojnë tezën e provimit ose të ankimojnë vlerësimin brenda 48 orëve. <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Dekani është përgjegjës të ngrejë një komision ad hoc për shqyrtimin e kërkesave për rishikim dhe ankimeve nga studentët. Vendimet e këtij komision merren brenda një jave the i komunikohen studentit. Pjesë e proces-verbalit është dhe fleta e provimit. Ky proces bëhet transparent në rregulloren e MSh AB neni 24 pika 4, 5, 6. <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Sipas nenit 4 pika 3 dhe 4 e rregullores së MSh AB programi garanton thellimin e njohurive nga Bachelor në Master në nivel praktik dhe shkencor. <a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sipas RVB lëndët Ekonometri dhe Menaxhim i Sistemeve të Informacionit japin njohuri mbi përdorimin e teknologjive të informacionit në fushën e këtij programi MSh AB.  Sic përmendet edhe më lart, <i>Ekonometria nuk është degë menaxhimi por ekonomie konceptualisht, prandaj GVJ mendon se nuk ka vend në këtë master.</i>  <i>Sugjerojmë të shikohen mundësi të futjes së lëndëve të tjera më të vlefshme për menaxherë dhe administrim biznesi, si për shembull sisteme ERP (Enterprise Resource Planning) krahas CRM që u përmendën në këtë vlerësim, njohuri të thelluara për Excel, simulime biznesi, dhe njohuri mbi menaxhimin dhe vizualizimin e të dhënave.</i>  <a href="#">RVB MSc "Administrim Biznes".pdf</a>

<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/ moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Studentët diskutojnë arritjen e objektivave të lëndës në klasë para provimeve përfundimtare dhe reflektojnë mbi nxënien për çdo lëndë na bazë të notave.</p> <p>Departamenti vlerëson kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në bazë të raporteve semestrale që çdo pedagog bën (Evidenca 3.2).</p> <p>Përmbledhjet që bëhen në fund të çdo lënde për njohuritë e marra, detyrat e kursit, si përgatitje për provimin dhe si përmbledhje praktike tregojnë plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Praktikat e sipërpërmendura do ishte e nevojshme të formalizoheshin në rregullore.</i></p> <p><a href="#">3.2 Formati raport vetevleresimi i stafit akademik, raport semestral.pdf</a></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni organizon leksione të hapura duke ftuar folës të jashtëm akademike ose nga biznesi si p.sh. KLSH ose Credins Fondi i Investimeve etj, siç tregohet në Evidencën 3.4. Këto leksione ofrojnë mundësi për studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre përtej programit.</p> <p><a href="#">3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare, 2019-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Laboratorët nuk parashikohen në kurrikulën e MSh AB (Aneks H.3), por institucioni ka laborator informatike me 25 kompjutera që e vë në dispozicion të studentëve.</p> <p>Kompetencat si bazë mësimdhënieje përmbledhen në lëndët specifike të programit MSh AB.</p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të caktuara.</p>	<p>Fakti që një pjesë e detyrave të kursit kryhet në grup është pozitive. Se sa konkretisht në nivel programi MSh AB dhe lëndësh nuk specifikohet. Është e nevojshme të detajohet gjithashtu edhe pesha që këto punë në grup kanë në notën e studentit për çdo lëndë duke siguruar një ndarje të drejtë të notave nga puna në grup në bazë të meritës për çdo anëtar grupi.</p> <p><i>Sa më sipër GVJ sugjeron të konsiderohen si elementë shtesë në rregulloren e MSh AB.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative,</p>	<p>Stafi akademik inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në konferenca dhe punime shkencore.</p> <p><i>Një tregues i mirë mund të ishte dhe përqindja e studentëve të MSh AB që vazhdojnë studimet e nivelit të tretë për doktoratë.</i></p> <p>Institucioni ka një traditë pozitive të organizimit të Konferencës Ndërkombëtare përveç vitit të fundit për arsye të tërmetit dhe pandemisë. Ndërkohë revista</p>

<p>studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Optime, botim i Universitetit ‘Albanian University’ siguron një mundësi komode për botime. Marrëveshja me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) (Evidenca 1.7) zgjeron mundësitë e bashkëpunimeve për kërkime shkencore, megjithëse për këtë program studimi, aktivitet i AMF nuk ka të njëjtën peshë si për një master në financë. Është pozitiv fakti që studentët dhe pedagogët mund të marrin pjese falas në konferencat dhe revistën Optime të vetë institucionit. Institucion ofron tarifa të reduktuara për anëtarët e stafit për pjesëmarrje në konferenca që organizon vetë.</p> <p><i>Siç përmendet edhe më lart, pjesëmarrja në kërkimin shkencor e stafit akademik dhe studentëve është e ulët. Ndoshta, përveç mbështetjes financiare, ulja e ngarkesës mësimore do të ishte një stimul i mirë.</i></p> <p><a href="#">1. Studente pjesemarrjes ne Konferenca.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Sipas RVB Tabelës 5 listohen 11 organizata partnere për projekte, evente dhe shkëmbim stafi, kryesisht të bazuara brenda vendit. Përmenden në raporte organizata partnere në Kine, Poloni, Rusi, Zvicër dhe Kosovë për projekte.</p> <p><i>Këto programe, sidoqoftë, mbeten në nivel të programit bachelor, dhe institucioni mund të bëjë më tepër për zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare edhe në këtë nivel masteri.</i></p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Sipas rregullores së MSh AB neni 33 diploma Master mund të fitohet duke realizuar mbrojtjen e një punimi diplome. Ky punim duhet të ketë një udhëheqës dhe një oponent. Rregullat e punimit dhe dorëzimit të diplomës përcaktohen gjithashtu edhe në rregulloren e përgjithshme të institucionit.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të</p>	<p>Procesi asistohet nëpërmjet vënies në dispozicion të një numri të gjerë temash për studentët që të mund të zgjedhin për diplomë. Një pedagog udhëheqës dhe sekretaria mësimore asistojnë studentin në punimin e diplomës. Institucioni ka paraqitur si evidencë listën e pedagogëve udhëheqës.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>

provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	N/A pasi ky kriter nuk përputhet me MSh AB në shqyrtim.
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studentët mbështeten periodikisht brenda 12 javëve (2 orë në javë) për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës orienton studentin në punimin e saj për diplomën. Ky proces kryhet sipas rregullores së MSh AB neni 33.</p> <p>Pedagogu udhëheqës sigurohet që studentit planifikon dhe zbaton projektin e diplomës në përputhje me interesin kërkimor, mundësitë e të dhënave dhe potencialin e studimit.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion laboratorin e informatikës dhe teknologjinë e informacionit përkatëse në të njëjtin shërbim të studentëve gjatë punimit të diplomës.</p> <p>Konfirmohet që pedagogu udhëheqës asiston studentin gjatë punimit të temës së diplomës dhe përgatit një raport paraprak për komisionin e vlerësimit para se studentit të paraqitet para tij. Ky format vlerësimi mat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilësinë e kërkimit dhe leximin e literaturës</li> <li>• Strukturën e temës</li> <li>• Progresin dhe cilësinë e argumenteve</li> <li>• Forcën e konkluzioneve ose rekomandimeve</li> <li>• Cilësinë e komunikimit dhe prezantimin e ideve</li> <li>• Krijueshmërinë, origjinalitetin dhe reflektimin</li> </ul> <p>Formati standard i vlerësimit është një kriter i mirë i cilësisë. Ai plotësohet edhe me komente.</p> <p>Vlerësimin përfundimtar të studentit për punimin e diplomës e bën komisioni i mbrojtës së temave të diplomave që ngrihet posaçërisht dhe vlerëson prezantimin që studentit i bën punimit të diplomës. Studenti vlerësohet me notë e cila regjistrohet në proces-verbalin e firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.</p> <p>Studenti me mbarimin e studimeve pajiset me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diplomën</li> <li>2. Listën e notave</li> <li>3. Suplementin e diplomës</li> </ol>

	<p>Këto dokumenta janë sipas formatit të miratuar nga MASR dhe të paraqitur si evidencë nga institucioni për këtë proces vlerësimi në Evidencën E2,3,4.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">3.10 Formatit i vlerësimit të temës së diplomës.pdf</a></p> <p><a href="#">E.2 Diploma – MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p> <p><a href="#">E.3 Lista e notave - MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p> <p><a href="#">E.4 Supplement - MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Institucioni ju jep të drejtën studentëve të kërkojnë dhe të marrin një kopje të plotë të programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara të firmosur nga titullari i institucionit.</p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	<p>Të dhënat e studentëve dhe rezultatet e tyre ruhen nga sekretaria mësimore. Në RVB thuhet shprehimisht që studentët kanë akses në këto të dhëna në çdo kohë.</p> <p>Nga takimi konfirmohet se Zyra e Karrierës dhe Alumni mban të dhënat e kontaktit dhe i azhuron ato për studentët pas diplomimit.</p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit	AU mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit MSh AB, personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe të personelit ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi.



<p>akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nëpërmjet konsultimit të dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore u konstatua se dokumentacioni i mbledhur dhe ruajtur nga zyra e Burimeve Njerëzore konsiston në: CV, Kontratë, Librezë pune, Fotokopje ID, Diploma dhe listë notash të noterizuara, Certifikatë të gjuhës së huaj, etj. Për stafin PAK ka edhe Lejen e angazhimit. Ndërsa, Raport Mjeko-Ligjor dhe Librezë shëndetësore u referuan si dokumenta të cilat i mban Administratori.</p> <p><a href="#">2 16-17-18-19 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</a></p> <p><a href="#">2.35 Formati i Dosjes personale të stafit.</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të hartuara në përputhje me bazën ligjore dhe të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të AU.</p> <p>Personeli përzgjidhet me konkurim sipas fazave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi i nevojave për staf akademik;</li> <li>2. Shpallja e vendeve të lira;</li> <li>3. Shqyrtimi i dosjeve dhe intervistimi;</li> <li>4. Punësimi dhe procedura administrative.</li> </ol> <p>Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për staf akademik përcaktohen nga Departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>Fillimisht kandidatët aplikojnë me dosje pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Kandidatët e përzgjedhur nga zyra, njoftohen më pas për fazën e dytë të konkursit. Gjatë fazës së dytë, kandidatët intervistohen dhe përzgjidhen nga Komisioni i Vlerësimit ad-hoc. Nga viti akademik 2017-2018, me vendim Senati (Aneks 4.1), nisur nga nevojat e departamenteve, procedurat hapen edhe para fillimit të semestrit të dytë (Ref. R1.b).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se këto procedura janë pjesë e akteve rregullatore dhe aplikohen nga institucioni në përzgjedhjen e stafit akademik.</p> <p>Referuar njoftimeve në faqen ëeb të institucionit, konstatohet se AU bën publike thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p><i>Sugjerohet që në këtë thirrje të publikohet edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc.</i></p> <p><a href="#">1.6 Rregullore e FSHAE.pdf, neni 19, pika 7</a></p> <p><a href="#">R.1.b Rekrutimi i stafit akademik, s.II 2018 - 2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.1.d Rekrutimi i stafit akademik, s.I 2020-2021.pdf</a></p> <p><a href="#">4.1 R.2 VS Nr. 24, Nr. 901.3 Prot., dt. 13 12 2017.pdf</a></p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2020/07/FSHAE-Vende-vakante-2020-2021.pdf">https://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2020/07/FSHAE-Vende-vakante-2020-2021.pdf</a></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	AU e plotëson këtë kriter, duke vënë në dispozicion të stafit akademik një godinë me infrastrukturë shumë të mirë, e pajisur me kompjuter, printer, fotokopje, internet, etj.  <a href="#">RVB, Tabela 16</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	AU përpiqet të mbështesë stafin akademik të MSh AB për zhvillim të mëtejshëm profesional, nëpërmjet botimit pa pagesë në revistën OPTIME apo organizimit të konferencave nga vetë institucioni.  <i>Përmendur edhe më lart, nuk ka evidenca lidhur me shpërndarjen dhe politikën që institucioni ka ndjekur në alokimin e fondeve kërkimore-shkencore midis stafit akademik.</i>  <i>Ekspertët rekomandojnë që institucioni të hartojë politika motivuese e stimuluese për stafin akademik të programit drejt një kërkimi shkencor të vazhdueshëm, duke mos e limituar vetëm me mundësitë institucionale, por zgjeruar edhe me pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikime në revista shkencore prestigjioze jashtë vendit.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	AU referohet në RVB për organizimin e leksioneve të hapura (Aneks 3.4), trajnimeve me trajnues vendas dhe të huaj, me focus metodat inovative të mësimdhënies, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik të programit, (Aneks 4.2 përmban tabela bosh).  Përsa i përket përdorimit të teknologjive të reja, duke qenë se edhe mësimi po zhvillohet online, DShE në bashkëpunim me NJSBC organizuan një trajnim në nivel Universiteti për nxitjen e përdorimit të platformës Google Classroom (Aneks 3.5)  <a href="#">4.2 Informacion mbi kontaktet e krijuara me Universitete, Shtator 2018 – Janar 2019).pdf</a>  <a href="#">3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare, 2019-2020.pdf</a>  <a href="#">3.5.b Axhenda e trajnimeve 2019-2020.pdf</a>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Referuar strukturës organizative si dhe vizitës në AU, institucioni dëshmon një angazhim pothuaj optimal të burimeve njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve MShAB.</p> <p><i>Vihet re një ngarkesë e lartë mësimore e stafit akademik (Tabela 4.1 dhe 4.2 në RVB), ku një PAE jep edhe 500 orë mësimore në semestër.</i></p> <p><a href="#">Tabela 4.1 dhe 4.2 në RVB</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar evidencave si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se AU disponon laborator informatike me 25 PC, auditorë për leksione dhe seminare si dhe një sallë konferencash, mjedise këto të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, si dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit MShAB.</p> <p><a href="#">4.3 Planimetrite.pdf, tabela 16</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon salla për seminare dhe leksione të pajisura me projektorë dhe tabela. Aktualisht mësimi po zhvillohet online, dhe institucioni ka marrë masat e duhura duke vënë në dispozicion platformat online.</p> <p>Ekspertët konkludojnë se këto mjedise janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit MShAB, por ndërkohë, sikurse përmendur edhe më herët, rezulton që <i>laboratori i teknologjisë nuk është i pajisur plotësisht me programe softërike specifike të lidhura me këtë MSh AB, sidomos të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit shkencor cilësor.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>GVJ rekomandon që AU të pajisë laboratorin e teknologjisë me programe softërike, si psh. SPSS, EVieës si edhe NVivo ose Atlas.ti, etj. të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave gjatë kërkimit shkencor sasior dhe cilësor si të stafit akademik ashtu dhe të studentëve.</i></p> <p><a href="#">4.3 Planimetrite.pdf,</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së</p>	

informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	AU bashkëpunon me institucione publike dhe private të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe veprimtarive të tjera praktike (Tabela 5, RVB).  Institucioni ka 25 marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për të realizuar praktikat profesionale të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	AU ka vënë në dispozicion të studentëve të programit MSh AB bibliotekën mësimore dhe ju garanton atyre mundësi të barabartë shfrytëzimi. Biblioteka u vizitua gjatë vizitës në institucion.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion si dhe referuar dokumentacionit të depozituar nga IAL, GVJ konstaton se biblioteka e AU është e pajisur në literaturë si tekste mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse me rreth 246 tituj librash në fushën ekonomike (Ref. RVB). Por GVJ konstaton se kjo literaturë është përtej 5-vjeçarit të fundit në disa fusha, si edhe ka mungesë titujsh për disa module si p.sh. Menaxhim Projektsh i Avancuar, Manaxhim Marketingu dhe Sjellje Organizative (Shënimet Dita II).  <i>GVJ rekomandon që institucioni të pasurojë literaturën e bibliotekës me një gamë më të gjerë botimesh bashkëkohore librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë përtej botimeve institucionale relevante për programin e studimit MShAB.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<a href="#">R.4 Kërkesë për pasurimin e bibliotekës 2020-2021.pdf</a>

<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>AU u siguron studentëve të programit të studimit MSh AB kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë në bibliotekat on-line ProQuest. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqeve elektronike të këtyre bibliotekave edhe në distancë, gjë e cila është shumë e nevojshme në situatën aktuale ku mësimi zhvillohet në distancë.</p> <p>Biblioteka operon me një orar 8.00-16.00 dhe 8.00-12.00 ditën e shtunë.</p> <p><i>Do të ishte më mirë një orar më i zgjatur si një përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave të studentëve të programit të studimit MSh AB.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që</p>	<p>Referuar vizitës në institucion, GVJ konstaton se informacioni lidhur me studentët e programit të studimit MSh AB mbahet nga sekretaria mësimore me anë të regjistrave manualë. Gjithashtu, AU ka vënë në dispozicion edhe sekretarinë online, ku çdo student ka kredencialet e tij për të marrë informacion të personalizuar lidhur me notat apo lëndët që duhet të frekuentojë.</p> <p>Ndërkohë të dhënat dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, mbahet në dosje nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan se AU mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit personelit akademik dhe studentëve nëpërmjet emaileve zyrtare, Office 365, Google Classroom.</p> <p><a href="#">4.4 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</a></p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/</a></p>

<p>mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<a href="http://on.albanianuniversity.edu.al/login">http://on.albanianuniversity.edu.al/login</a>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>GVJ konstaton se informacionet lidhur me programin e studimit MSHAB, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqipe, dhe pjesa më e madhe e tyre edhe në gjuhën angleze.</p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/</a></p> <p><a href="http://au.albaniancollege.edu.al/en/department-of-economic-sciences/">http://au.albaniancollege.edu.al/en/department-of-economic-sciences/</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të</p>	<p>Referuar kreut IX të Statutit si dhe vecanërisht neni 74, Planit Strategjik institucional dhe atij të zhvillimit të DSHE, si edhe RVB, ekspertët mendojnë se AU harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen institucionale. Ky plan financimi institucional përmban kostot e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, investimet për laboratorin e informatikës si dhe detyrime të tjera financiare.</p> <p>Megjithatë, <i>GVJ gjykon të nevojshme që institucioni të hartojë raporte financiare si dhe planin për mbështetjen financiare të detajuar për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit MShAB referuar kohës të këtij cikli studimi 2-vjeçar.</i></p> <p><a href="#">Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15.pdf, neni 74</a></p> <p><a href="#">1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf</a></p>

realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	<a href="#">3.7 Plani strategjik i zhvillimit të DSHE 2018-2019.pdf</a> <a href="#">RVB</a>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifave dhe shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	Referuar informacionit përshkrimor (por pa evidenca) në RVB raportimi financiar i AU përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe institucioni i nënshtrohet kontrollit të Degës së Tatim Taksave.  <i>Bazuar në kriterin 3, GVJ rekomandon që institucioni, përtej dokumentimit të gjendjes financiare, të vlerësojë edhe efektivitetin financiar të programit MSh AB, si dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave të domosdoshme për të garantuar qëndrueshmërinë e tij financiare.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik	Rregullorja e programit MSh AB (Evidenca H3), rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve (Evidence 2.3) si dhe rregulloret në nivel fakulteti dhe institucioni përcaktojnë procedurat e hyrjes dhe daljes së studentëve në program,

<p>të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>si ata mund të regjistrohen, kriteret që duhet të përmbushin, kërkesat mësimore dhe përfundimin me diplomë.</p> <p>Sekretaria mësimore mbikëqyr këtë proces.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">2.3 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucion në RVB shprehet që pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Angazhimi ndaj zbatimit dhe përkthimi i tij në rregulloren e programit, fakultetit dhe institucionit është një bazë e mirë për të garantuar barazinë e të drejtave të njëjta.</p> <p>Nga vlerësimi nuk lihet të dyshohet për diskriminim ndaj studentëve.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni duket i hapur për sa i përket kriterëve të pranimit të studentëve në program. Në Rregulloren e programit Evidenca H3 Neni 10 thuhet se për të ndjekur programin MSh AB çdo kandidat është i detyruar të plotësojë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të ketë diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor apo të sistemit të vjetër (minimumi 3 vjet)</li> <li>2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimit të njësisë bazë</li> <li>3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore.</li> </ol> <p>Kriteret në pikën 2 mund të ishin specifikuar më mirë në rregullore.</p> <p>Kritere shtesë kanë të bëjnë me dokumentacion shtesë për sa më sipër, përputhshmërinë e studimeve të mëparshme, rezultateve dhe motivimin e kandidatëve. Këto kritere sa më sipër të shprehura në rregullore janë në dispozicion të kandidatëve.</p> <p>Në rregulloren e MSh AB neni 10 gjithashtu kërkohet gjithashtu që diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme në masën 70% me programin e studimit MSh AB.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit (Evidenca H3) Neni 10 thuhet se 'institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p> <p><i>Evidenca e paraqitur nuk specifikon se si kanë ndryshuar këto kritere në kohë vit pas viti, nëse ka një notë minimale për pranimin në këtë MSh AB ose kritere të tjera kufizuese.</i></p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Në Nenin 10 të rregullores së MSh AB institucioni udhëzon kandidatët për kriteret e pranimit në Nenin 11 thuhet se institucioni ngre struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. [...] Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit që ofrohen si dhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion. Studentë informohen se u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin jepen në rregulloren e programit MSh AB [Evidence H.3, Neni 25, fq. 15 - 16]:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh.</li> <li>Studenti detyrohet të frekuentoje lëndët e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit. (Kërkesat specifike për frekuentimin përcaktohen edhe në syllabuse).</li> <li>Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës (ose provim formimi), nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.</li> </ol> <p>Institucioni sqaron mënyrat e përparimit në studimin e lëndëve dhe program në rregulloren e programit.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Për këtë proces është përgjegjëse Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalenlimeve të Studimeve [Evidence 2.3].</p> <p>Në rregulloren e MSh AB neni 10 gjithashtu kërkohet gjithashtu që diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme në masën 70% me programin e studimit MSh AB.</p> <p>Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve, në përputhje me ligjin, parashikon gjithashtu edhe rastet e transferimeve nga një program i akredituar në tjetrin dhe njohjen e krediteve.</p> <p>U panë dhe u verifikuan disa dosje studentësh të regjistruar në sekretari.</p>

	<a href="#">2.3 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.pdf</a>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Informimi i studentëve, siç u konfirmua edhe me ata vetë, bëhet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Syllabusave dhe materialeve informuese për programin kur studentit regjistrohet.</li> <li>2. Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve gjatë javës së parë orientuese.</li> <li>3. Pedagogëve të secilës lëndë në fillimin e studimeve.</li> </ol> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Përgjegjësi i Departamentit informon studentët për procedurën e punimit të diplomës. Një gjë e tillë shpjegohet edhe në rregulloren e MSh AB ku ndër të tjera thuhet se diploma Master mund të fitohet duke realizuar mbrojtjen e një punimi diplome. Procesi asistohet nëpërmjet vënies në dispozicion të një numri të gjerë temash për studentët që të mund të zgjedhin për diplomë. Studentët mbështeten periodikisht brenda 12 javëve (2 orë në javë) për punimin e diplomës.</p> <p>Udhëheqësi i temës orienton studentin në punimin e saj për diplomën. Ky proces kryhet sipas rregullores së MSh AB neni 33. Format i vlerësimit të diplomave mat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilësinë e kërkimit dhe leximin e literaturës</li> <li>• Strukturën e temës</li> <li>• Progresin dhe cilësinë e argumenteve</li> <li>• Forcën e konkluzioneve ose rekomandimeve</li> <li>• Cilësinë e komunikimit dhe prezantimin e ideve</li> <li>• Krijueshmërinë, origjinalitetin dhe reflektimin</li> </ul> <p>Vlerësimin përfundimtar të studentit për punimin e diplomës e bën komisioni i mbrojtës së temave të diplomave që ngrihet posaçërisht.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	<p>Departamenti ka përgjegjësinë e informimit të studentëve të ardhshëm.</p> <p>Publikimi i informacionit periodik, zyra përkatëse e ngarkuar me këtë qëllim dhe shembuj udhëzuesish për studentët nuk jepen në RVB ose evidencën e paraqitur.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve bëhet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Syllabusave dhe materialeve informuese për programin kur studentit regjistrohet.</li> <li>2. Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve gjatë javës së parë orientuese.</li> <li>3. Pedagogëve të secilës lëndë në fillimin e studimeve.</li> </ol> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese për programin MSh AB përfshihen në syllabuset (Evidenca 2.2). Aty përfshihen emrat e çdo lënde, pedagogët, kreditet, viti, e detyrueshme ose jo, emaili i titullarit të lëndës si dhe temat, aktivitetet dhe mënyra e vlerësimit. Pedagogët e lëndëve bëjnë një përmbledhje në fillim të çdo lënde.</p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Përgjegjës për orientimin e studentëve drejt tregut të punës janë Zura e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe Zura e Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Aktivitetet e këtyre zyrave rregullohen nga rregullore përkatëse (Evidenca 5.2 dhe 5.3).</p> <p>Në Bazë të tabelës 5 në RVB institucioni ka lidhje me 25 organizata dhe biznese për praktika mësimore. Ky informacion supozohet ju jepet edhe studentëve.</p> <p><a href="#">5.2 Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve.pdf</a></p> <p><a href="#">5.3 Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni informon studentët nëpërmjet sekretarisë online dhe faqes së internetit për logjistikën e mësimdhënies, oraret, klasat dhe aktivitetet, duke i vënë njëkohësisht këto në dispozicion të mësimorit. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për këtë proces.</p> <p><a href="http://albanianuniversity.edu.al/en/home/">http://albanianuniversity.edu.al/en/home/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni përdor komunikim nëpërmjet takimeve, broshurave dhe prezantimeve në javën e parë dhe vazhdimësi të studimeve, si dhe metodat si më poshtë për informim në distancë ose elektronik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqja zyrtare e Albanian University (www.albanianuniversity.edu.al)</li> <li>• Komunikimi nga departamenti</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmes emailit</li> <li>• Nëpërmjet rrjeteve sociale</li> </ul> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Përgjegjës për sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit është sekretaria mësimorë dhe zyra e Administratorit të Përgjithshëm. Kjo gjë organizohet në përputhje me rregulloren e sekretarisë mësimore (Evidenca 4.4) <p><a href="#">Aneks 4.4 Rregullore e sekretarisë mesimore.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Sekretaria dhe kryesekretaria janë përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave statistikore të studentëve. <p>Tabela 23 e paraqitur si evidencë ka të dhënat si më poshtë për 2018-2020:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri total i të diplomuarve - 18</li> <li>• Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën– 16</li> <li>• Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën 2</li> </ul> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Në bazë të Rregullores së Sekretarisë Mësimore (Evidenca 4.4) institucioni duhet t’i zotërojë të dhënat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit. Një gjë e tillë u evidentua nga takimi me zyrën e sekretarisë mësimore dhe shqyrtimit të regjistrave të studentëve për të gjitha vitet. <p>Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në regjistrin hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Tabela në vijim pasqyron numrin e studentëve për tre vitet akademike të fundit. Në vitin akademik 2019-2020 rezultoi një student ende i pamatrikulluar dhe ai ka kaluar në stazh për mos-paraqitje.</p>

	<p>Kurse ne vitin aktual akademik janë ende 5 studentë të pamatrikular. Transferime nuk ka.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Regjistruar per here te pare</th> <th>C'regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>13</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>19</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>21</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p><a href="#">4.4 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</a>  <a href="#">Shenime (dita e dyte) Msc Administrim Biznesi AU Renata.pdf</a></p>				Viti akademik	Regjistruar per here te pare	C'regjistruar	2018-2019	13	1	2019-2020	19	0	2020-2021	21	
Viti akademik	Regjistruar per here te pare	C'regjistruar														
2018-2019	13	1														
2019-2020	19	0														
2020-2021	21															
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Sekretarisë Mësimore (Evidenca 4.4) institucioni duhet t'i zotërojë këto të dhëna. Këto të dhëna ruhen në mënyrë rigoroze nga sekretaria mësimore. Ato u shqyrtuan gjatë këtij procesi vlerësimi. Sekretaria mësimore dhe institucioni raporton këto të dhëna edhe në MASR.</p> <p><a href="#">4.4 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</a></p>															
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Përgjegjës për ruajtjen e këtij informacioni është Sekretaria Mësimore në bazë të rregullores përkatëse.</p> <p>Thuhet shprehimisht në RVB se ky informacion është i sigurt dhe lehtësisht i aksesueshëm nga studentët.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Departamenti kanë përgjegjësinë e vënies në dispozicion të këtij informacioni studentëve dhe një gjë e tillë ndodh pa probleme.</p> <p><a href="#">4.4 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</a></p>															
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Institucioni ka për detyrë të hartojë raporte analitike në bazë të rregullores së sekretarisë mësimore (Evidenca 4.4). Këto raporte departamenti i përgatit në nivel programi (Evidenca R5 a, b) dhe ja kalon institucionit në nivel Dekanati, Rektorati, Senati dhe së fundmi Bordi Administrimi, struktura të cilat marrin vendimet përkatëse. Zyra të veçanta për kurrikulat dhe kontrollin e cilësisë mbështesin këtë proces.</p> <p><a href="#">4.4 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</a>  <a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a>  <a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>															
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>												
				<p><b>X</b></p>												

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Rregullorja e Albanian University Neni 58 përcakton që studentët mund të formojnë Këshillin Studentor organet dhe përfaqësuesit e të cilit zgjidhen me votë.</p> <p>Kryetari i Këshillit Studentor merr pjesë në Senatin Akademik dhe studentët mund të kenë përfaqësues në mbledhjet e departamentit.</p> <p><i>Kjo marrëdhënie përfaqësimi nuk përmendet në rregulloren e IAL. Rregullorja e institucionit në mënyrë specifike nuk përfshin studentët në aktivitetin e Bordit të Administrimit që është organi drejtues kolegjal administrative më i lartë.</i></p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Kryetari i Këshillit Studentor merr pjesë në Senatin Akademik dhe studentët mund të kenë përfaqësues në mbledhjet e departamentit.</p> <p>Një problematikë konkrete, për shembull, ishte problemi ngrohjes, për tej këtij programi MSh AB, i ngritur nga studentët dhe i zgjidhur nga institucioni.</p> <p>Sa më sipër tregon se institucioni ka një përjasje proaktive ndaj problemeve të studentëve dhe çështjeve që ata ngrenë.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Tabela 13 e paraqitur si evidencë përmbledh sa më poshtë për MSh AB tregon 1244 (1242 sipas Rregullores së programit, përmendur më lart) lëndë për leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktika dhe diplome. Një sasi e tillë orësh është e përshtatshme, dhe nga takimi me studentët nuk u evidentua ndonjë problem.</p> <p>Institucioni ka në dispozicion kapacitetet për hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, por se <i>sa dhe si arrihet kjo konkretisht nuk shpjegohet qartë, në mënyrë krahasimore dhe të matshme.</i></p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në RVB thuhet që sipas nenit 25 të Statutit të "Albanian University" studentët kanë përfaqësi të përhershme në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.</p> <p>Një kopje e statutit është paraqitur si evidencë. Studentëve ju sigurohet një mundësi të mjaftueshme shprehjeje dhe përfshirjeje në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit, megjithëse strukturat e sipërpërmenduar nuk kanë fuqinë vendimmarrëse të Senatit ose Bordit të Administrimit.</p> <p>Në takime u fol edhe për përfshirjen më të madhe të alumni në të ardhmen.</p> <p><a href="#">3. Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15.pdf</a></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës</p>	<p>Rregullorja e MSh AB parashikon që studentët kanë të drejtë të shikojnë fletët e vlerësuara të provimeve si dhe të kërkojnë rishikim të vlerësimeve.</p> <p>Dekani është përgjegjës të ngrejë një komision ad hoc për shqyrtimin e kërkesave për rishikim dhe ankimimeve nga studentët. Vendimet e këtij komision merren brenda një jave the i komunikohen studentit. Pjesë e proces-verbalit është dhe fleta e provimit. Ky proces bëhet transparent në rregulloren e MSh AB neni 24 pika 4, 5, 6.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni ka marrë disa masa për angazhimin e personelit akademik në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një Zv/Rektor për Kërkimin Shkencor</li> <li>2. Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike</li> <li>3. Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimet</li> <li>4. Revistën Optime</li> </ol> <p>Institucioni organizon Konferencën Ndërkombëtare në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, UBT dhe La Sapienza Romë, Konferencën Studentore me AMF. Megjithatë, sic përmendet edhe më lart, punimet shkencore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është i ulët dhe nuk ka pjesëmarrës në këto aktivitete shkencore nga studentët e MSh AB).</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Institucioni tregon gatishmëri për partneritete për projekte, kryesisht në kuadrin e Horizon2020. Jepet evidencë për katër aplikime për projekte të tilla në periudhën 2018-2020.</p> <p>Projekt i fituar duket të jetë ai me emrin GRADUA (Erasmus + CBHE) ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë. Në RVB gjithashtu përmenden disa partneritete me institucione arsimore në Kinë, Poloni etj.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Revista Optime e botuar nga vete Albanian University ju jep mundësi edhe studentëve të botojnë, dhe stafi pedagogjik mund t'i motivojë studentët për të marrë pjesë, kryesisht ata në nivel diplome.</p> <p>Jepen krahas RVB shembuj studentësh që kanë marrë pjesë në konferenca, si për shembull ajo mbi Edukimin Financiar në 2019.</p> <p><a href="#">2.8 Revista Optime.pdf</a></p> <p><a href="#">1. Studente pjesemarres ne Konferenca.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>RVB dhe evidenca e shkruar shoqëruese jep shembuj vetëm për angazhime në konferenca dhe revista shkencore kombëtare.</p> <p>Evidenca të shkruara të paraqitura në RVB për botimet e personelit akademik dhe studentëve në revista ndërkombëtare nuk ka.</p> <p>Është pozitiv fakti që institucioni ka një formular vlerësimi për aktivitetin shkencor dhe botimet e stafit akademik të cilin ata e plotësojnë çdo vit.</p> <p><a href="#">1. Studente pjesemarres ne Konferenca.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të eksplorojnë nëpërmjet kërkimit dhe aplikimeve në praktikë zgjidhje inovative që mund të çojnë në regjistrimin e patentave, por nuk mendohet që një gjë e tillë ndodh shpesh edhe për nga vetë natyra e programit MSh AB e bazuar më tepër në fushat sociale.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Këtij kriteri nuk i është dhënë përgjigje në RVB.</p> <p><i>Institucioni mund të ishte shprehur në lidhje me ndihmesën që udhëheqësit akademikë ju japin studentëve në aplikimin e programeve dhe metodave analitike për shqyrtimin e të dhënave.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

### Standardi V.7

**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe</p>	<p>Sipas RVB dhe evidencës së paraqitur pedagogë nga departamenti kanë marrë pjesë në takime të organizuara nga Agjencia për Kërkim Shkencor dhe Zyra Erasmus Tiranë, pa dhënë detaje se sa nga këta pedagogë janë staf i MSh AB në shqyrtim.</p>



<p>mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Evidencë për sa më sipër jepet në raportet e departamentit (Evidenca R5 a dhe b) ku listohen një sërë projektsh për të cilat anëtarë të stafit akademik të këtij programi janë angazhuar dhe ku kanë arritur financim të suksesshëm. Mobiliteti i stafit arrihet nëpërmjet këtyre mënyrave bashkëpunimi dhe projektsh, ndërsa për sa i përket studentëve interesi i tyre duket më i ulët.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Programi MSh AB jep njohuri praktike për fusha të ndryshme praktike si financë, menaxhim operacionesh, marketing etj që studentët mund të konsiderojnë për kërkime të thelluara shkencorë në ciklin e tretë.</p> <p>Lënda Metoda Kërkimi dhe Ekonometri jep njohuri të vlefshme për anën metodologjike të kërkimeve në ciklin e tretë. Edhe këtu vlen komenti i mesiper për angazhim më aktiv të studentëve në aktivitete kërkimore.</p> <p><a href="#">2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc “Administrim Biznes” 2020-2021.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Programi Erasmus i përmendur i referohet shkëmbimeve me karakter mësimin, jo kërkimin shkencor për studentët. Nga takimet u evidentua që studentët e MSh AB nuk përfshihen në programe Erasmus. Ka disa studentë nga institucioni që marrin pjesë në punime shkencore për konferenca, por sa më sipër evidenca i përket vitit 2017 para akreditimit të fundit.</p> <p><a href="#">1. Studente pjesemarres ne Konferenca.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni është i interesuar për bashkëpunime me kërkues të huaj për projekte dhe ka aplikuar për një sërë projektsh të tilla. Evidenca tregon angazhimin e disa profesorëve të programit të studimit të angazhuara me projekte shkencore dhe kolegë të huaj.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni është i hapur dhe nxit shkëmbimet studentore nëpërmjet programit Erasmus dhe Erasmus Plus duke koordinuar mundësitë me zyrën e Erasmus Tiranë dhe duke ndarë këto mundësi me studentët. Gadishmëria e institucionit për transferimin e krediteve të fituar nga mobiliteti shprehet në RVB.</p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Nuk është dhënë një përgjigje për këtë pikë në RVB dhe nuk ka evidencë nëse një gjë e tillë konsiderohet nga institucioni.</p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf</a></p>			
	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			<b>X</b>	
--	--	--	----------	--

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Institucioni ju jep të drejtën e organizimit nëpërmjet Këshillit Studentor të parashikuar në rregulloren e Albanian University.</p> <p>Ne rregulloren e MSh AB studentët kanë të drejtë të informohen mbi rezultatet dhe t'i ankojnë ato brenda procedurave të parashikuara.</p> <p>Ndërkohë institucioni mban komunikim të mirë dhe të vazhdueshëm në lidhje me mësimdhënien dhe mundësi të tjera.</p> <p>Sa më sipër janë në përputhje me aktet rregullatorë të Albanian University.</p> <p><a href="#">H.3 Rregullore e Msc. Administrim Biznesi.pdf</a></p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Strukturat që institucioni ka ngritur për të informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve</li> <li>• Zyra e Karrierës dhe Alumni</li> <li>• Departamenti nëpërmjet konsultimeve me pedagogë</li> <li>• Sekretaria Mësimore</li> </ul> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni mbështesin studentë në zgjedhjet e tyre të karrierës si dhe organizojnë aktivitete për të nxitur një gjë të tillë.</p> <p>Ato gjithashtu asistojnë studentët për praktikat mësimore me 25 kompani të listuara në Tabelën 5 si evidencë.</p> <p>Një fakt i rëndësishëm është që shumica e studentëve të MSh AB duket se janë të punësuar gjatë kryerjes së studimeve, në një masë të madhe në rolë të lidhura me MSh AB.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p> <p><a href="#">RVB MSc “Administrim Biznes”.pdf Tabela 5</a></p>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh,	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni është përgjegjëse për ruajtjen dhe azhurnimin e të dhënave të studentëve pas diplomimit.</p>

përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	<i>Do ishte me vlerë që krahas RVB të ishte paraqitur një evidencë se si përdoren këto të dhëna nga autoritetet drejtuese, si dhe nëse kryhen organizime për të mbajtur të angazhuar Alumni nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</i>  <a href="#">5.3 Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e ngritur me vendim të Senatit dhe e cila funksionon në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe me Manualin "Procedural dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit".  Gjithashtu, AU ka ngritur edhe Grupin e Sigurimit të Cilësisë në Nivel Departamenti (Aneks 6.3).  <a href="#">6.1 VS - krijimi i ZSBC - 23 07 2010.pdf</a>  <a href="#">6.8 Rregullore NJSBC.pdf</a>  <a href="#">6.3.c Sigurimi i Cilësisë në Nivel Departamenti, 2020-2021.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka dhe menaxhon Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ngritur me vendim Senati në 2010. Për të institucionalizuar këtë sistem, AU ka ngritur mekanizmat e mëposhtme:  1. Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 2. Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional 3. Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

	<p>Këto struktura përfshijnë edhe angazhimin e ekspertëve të jashtëm si juristë e konsulentë për përmirësimin e kurrikulave.</p> <p>Nga Shtatori i vitit 2016 funksionon edhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivelin e njësisë bazë.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p> <p><a href="#">6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në AU.pdf</a></p> <p><a href="#">6.5.a VB -.pdf</a></p> <p><a href="#">6.5.b VB -.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka një eksperience shumë vjeçare vlerësimi të jashtëm nëpërmjet proceseve të akreditimit. Ai ngre një grup pune që shqyrton kërkesat dhe sugjerimet e bëra nga vlerësuesist e jashtëm dhe Bordi i Akreditimit, përpilon një RVB të detajuar dhe siguron evidencën përkatëse për akreditimin e radhës.</p> <p>Gjatë këtij procesi vlerësimi konfirmohet gatishmëria e institucionit për një përfaqje proaktive ndaj procesit të vlerësimit të jashtëm dhe gatishmëri për të vënë në dispozicion gjithë evidencën e kërkuar.</p> <p><a href="#">H.1.d VBA nr. 80, datë 27.10.2018, Akreditimi MSc Administrim Biznesi.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit dhe zyrat përkatëse të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe proceseve periodike të vlerësimit të jashtëm (nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit) siguron që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi akademik vlerësohet në mënyrë periodike nga studentët dhe departamenti.</li> <li>• Departamenti vlerësohet nga studentët, institucioni dhe grupet e vlerësimit të jashtëm</li> <li>• Studentët vlerësohen nëpërmjet procesit mësimor nga ana akademike nëpërmjet pedagogëve dhe nga ana administrative nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe zyrave të tjera mbështetëse</li> </ul> <p>Këto tre sisteme vlerësimi të ndërthurura nga njëri tjetri dhe me aktivitet të rregulluar në rregulloret përkatëse kanë pushtet të balancuar dhe janë përgjegjës të mirë për krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional.</p> <p><i>Në të njëjtën kohë, GVJ sugjeron që institucioni të konsultohet edhe me punëdhënësit dhe biznese të ndryshme lidhur me nevojat e tregut të punës si dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit.</i></p> <p><a href="#">6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në AU.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Referuar nenit 2 të Rregullores së NJSBC, kjo njësi përbëhet nga 5 anëtarë, ku 4 janë staf akademik të emëruar nga senati dhe 1 student. Me vendim rektorati janë miratuar edhe 2 ekspert të jashtëm, por këta nuk përmenden në rregulloren e NJSBC. Kurse, Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti ngrihen ad hoc për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit. Këto grupe përbëhen nga 2-3 pedagogë me tituj që shqyrtojnë kurrikulat dhe syllabus, kërkesat për përditësim të lëndëve, nevojat e studentëve dhe përpilojnë një raport që informon grupet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p><i>GVJ sugjeron përfshirjen e ekspertëve të jashtëm si dhe një anëtar nga stafi administrativ në Rregulloren e kësaj njësie.</i></p> <p><a href="#">6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në AU.pdf</a></p> <p><a href="#">6.8 Rregullore NJSBC.pdf</a></p> <p><a href="#">6.5.a VB -.pdf</a></p> <p><a href="#">6.5.b VB -.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Shqyrtimi, miratimi dhe mbikëqyrja e programit rregullohen sipas rregullores së Albanian University dhe rregullores specifike të këtij programi MSh. AB, kryesisht nëpërmjet strukturave të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave</li> <li>• Grupit të Sigurimit të Cilësisë</li> <li>• Bordit të Akreditimit</li> </ul> <p>Gjithashtu, insitucioni kryen proceset formale të aplikimit për akreditimin e këtij programi (ky është akreditimi i tretë), në të cilat janë evidentuar problematikat dhe përpjekjet e institucionit për të plotësuar rekomandime nga ekspertë të jashtëm.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Instrumentet matëse që institucion përdor janë:</p> <p><u>Te tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetësorë të studentëve (2 here ne vit) [R.5.a,b],</li> <li>• Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. [Evidence 6.7],</li> <li>• Raporte vetëvlerësimi te pedagogeve [Evidence 3.2],</li> </ul> <p><u>Te drejtpërdrejta:</u></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi me note dhe pikë;</li> <li>• Teste paraprake dhe përfundimtare;</li> <li>• Vëzhgime gjate kryerjes se praktikave dhe ushtrimeve.</li> </ul> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">6.7.a Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve -Shkurt 2019.pdf</a></p> <p><a href="#">6.7.b Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve- Janar 2020.pdf</a></p> <p><a href="#">3.2 Formati raport vetevlerësimi i stafit akademik, raport semestral.pdf</a></p>								
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Informacioni për vlerësimet në nivel studentësh, pedagogësh, procesi mësimor dhe punës kërkimore i dërgohen institucionit në nivele të ndryshme, nga departamenti në Rektorat, Senat dhe Bordin e Administratorëve.</p> <p>Secila nga këto struktura pasi vihet në dijeni merr vendime përkatëse për ndryshime të nevojshme të cilat implementohen sipas rregulloreve përkatëse.</p> <p><a href="#">1.4 Rregullore Albanian University.pdf</a></p>								
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	<p>Raportet e vlerësimit (Evidenca R 5 a dhe b) japin të dhënë të detajuara dhe të matshme për gjëndjen e programit, kërkesat dhe vlerësimet e studentëve, angazhimin e stafit akademik dhe mbarëvajtjen. Instrumenti që lejon një përqsja krahasimore është analiza SWOT ku reflektohet mbi mundësitë dhe sfidat në të ardhmen duke marre parasysh ndryshime të mundshme.</p> <p>Është gjithashtu pozitiv fakti që institucioni dhe programi merr parasysh vlerësimet e jashtme të proceseve të akreditimit dhe implementon ndryshimet përkatëse brenda mundësive.</p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njëjësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në

Referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ, konstaton se NJSBC kryen vlerësime të brendshme të programit të studimit në mënyrë periodike, i cili është i përfshirë në vetëvlerësimin

<p>vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p>Metoda dhe instrumente të ndryshëm janë përdorur nga njësia për kryerjen e këtij vlerësimi, nga ku mund të përmenden metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, AU përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si: focus-grupe e intervista të studentëve e të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> <p><i>Qëndron rekomandimi i mësipërm që institucioni të konsultohet edhe me punëdhënësit dhe biznese të ndryshme lidhur me nevojat e tregut të punës si dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit.</i></p> <p><a href="#">R.5.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p> <p><a href="#">6.7.a Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve -Shkurt 2019.pdf</a></p> <p><a href="#">6.7.b Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve- Janar 2020.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Rregullorja e NJSBC përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë në tërësinë e tyre, <i>por mungon një dokument i cili specifikon përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të njësisë.</i></p> <p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p><i>GVJ rekomandon si edhe më lart, përfshirjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm nga tregu i punës si dhe një anëtar nga stafi administrativ në këtë njësi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Ekspertët konstatojnë se AU ka të publikuar në faqen e tij ëeb statutin, rregulloren dhe raportin vjetor të NJSBC për vitin akademik 2019-2020. Raporti i NJSBC është hartuar duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. NJSBC si strukturë nuk harton plan masash në raportin vjetor.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p><i>GVJ rekomandon që institucioni të integroje në raporte në bazë programi ku të përfshihen analiza mbi vlerësimet e përmirësimit të mangësive dhe dobësive të evidentuara dhe plan programi në periudhat e ardhshme (Aneks 3.2 paraqet vetem formular bosh).</i></p> <p>AU duhet të marrë masa për të siguruar efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, dhe impakti i tyre të jetë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><a href="#">3.2 Formatit raport vetevleresimi i stafit akademik, raport semestral.pdf</a></p> <p><a href="#">R.5.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Ekspertët konstatojnë se AU organizon takime periodike me stafin dhe studentët lidhur me mbarëvajtjen mësimore dhe fokus ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, të Universitetit Privat “Albanian University”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi gëzon një mbështetje dhe drejtim shumë të mirë të vënë në dispozicion nga institucioni duke garantuar informimin, cilësinë e mësimdhënies, vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme për mësimdhënie dhe mbështetjen ndaj studentëve me materiale.
2. Kurrikula e programit është në përputhje me programe të ngjashme në vend dhe jashtë. Kjo ju mundëson studentëve në këtë MSh AB një rritje graduale të kapaciteteve në përputhje me fushat e mëparshme të studimit.
3. Stabiliteti dhe reputacioni që ka ky program masteri në institucionin Albanian University janë konsoliduar në tregun e studimeve universitare në Shqipëri. Kjo i jep programit një avantazh

konkurrues kundrejt programeve të reja, kryesisht për faktin që programi vazhdon të përditësohet dhe përmirësohet vazhdimisht për ta ruajtur këtë avantazh konkurrues.

4. Praktikantët mësimorë ju japin studentëve mundësi të eksplorojnë dhe zbatojnë në praktikë ato që kanë mësuar gjatë këtij programi, duke zgjeruar njëkohësisht edhe rrjetin e lidhjeve të tyre me kompani reale.
5. Vlerësimi me notë i pjesëmarrjes në klasë në masën 20% është faktor shumë pozitiv pasi siguron jo vetëm përkushtimin dhe pjesëmarrjen e studentëve gjatë gjithë procesit të mësimdhënies, por ju jep edhe pedagogëve mundësinë të fusin dhe përdorin metoda inovative mësimdhënieje.

### **Pika të dobta**

1. Përputhja e profilit akademik të stafit, rekomandim ky edhe i akreditimit të viti 2018, të evidentuar nëpërmjet diplomave të tyre dhe lëndëve që ata japin mund të ishte më e mirë, duke mos e justifikuar vetëm nëpërmjet eksperiencës së tyre të punës, por edhe nëpërmjet punës së tyre kërkimore të prezantuar në konferenca ose të botuar.
1. Njohuri e ulët e studentëve me metodat e kërkimit shkencor dhe përfshirje e ulët e personelit akademik dhe studentëve në aktivitete dhe botime shkencore, gjithashtu rekomandim i akreditimit të mëparshëm në vitin 2018.
2. Mundësi të kufizuara për të qenë konkurrues në një nivel ndërkombëtar si rrjedhojë e një përdorimi të kufizuar të materialeve dhe mënyrave të vlerësimit në gjuhë të huaj (anglisht) ose literaturës së huaj në masë të gjerë në materialet mësimore bazë.
3. Mungesa e raporteve mbi efektivitetin financiar dhe planin për mbështetjen financiare referuar kohës së këtij cikli studimi 2-vjeçar për të garantuar qëndrueshmërinë e programit në bazë të tregut të punës dhe kërkesës.
4. Mungesa e një plan-buxheti i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe kriteret e financimit për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, si dhe nuk disponohet një procedurë transparente për alokimin e fondeve në kuadër të kërkimit shkencor.
5. Fondi fizik i bibliotekës është i kufizuar në numër dhe botime të reja.
6. Ngarkesa e lartë në orë mësimore, ku një PAE jep edhe 500 orë mësimore në semestër, mund të çenojë cilësinë e programit por edhe uljen e angazhimit në aktivitete kërkimore-shkencore.
7. Mungesa e kriterëve specifikë në pranimin e studentëve që mund të vijnë nga fusha të tjera studimi.

### **Rekomandime**

1. Të konsiderohet përputhshmëria midis profilit akademik të stafit të angazhuar dhe lëndëve që ata mbulojnë.
2. Institucioni të rrisë mbështetjen për stafin akademik dhe studentët për pjesëmarrje në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar si dhe për botime shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare me faktor impakti.

3. Ulje e ngarkesës mësimore, si motivim për angazhim më të madh në projekte kërkimore-shkencore, apo në metodat e reja e të mësimdhënies. Motivim i stafit mësimdhënës me çmime që jepen periodikisht për arritje në metoda mësimdhënieje inovative në bazë të një vlerësimi të bërë nga departamenti dhe nga vetë studentët.
4. Të përmirësohet profili ndërkombëtar i programit të studimit. Të shtohet kërkesa dhe bërja e mundur e dorëzimit të detyrave të kursit edhe në anglisht, fillimisht si opsion me zgjedhje.
5. Institucioni duhet të veçojë programet e menaxhimit dhe shkencave ekonomike nga shkencat e aplikuara si inxhinieria dhe design në një fakultet tjetër si Fakulteti i Shkencave Shoqërore, ose të konsiderojë një integrim më të mirë të menaxhimit dhe ekonomisë me inxhinierinë dhe design.
6. Të përditësohet literatura e parashikuar në syllabuset e këtij programi studimi, me botime të pesë viteve të fundit.

### **Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Business Administration" of the Private University "Albanian University"**

#### Strengths and affirmations

1. The programme receives excellent support and leadership from the institution which guarantees the information, the quality of teaching, the availability of the necessary didactic equipments and support towards the students with materials.
2. The syllabuses of the programme are aligned with similar programmes in and outside the country. This enables students taking this MSc AB to achieve a gradual growth of their capabilities in accordance with their prior areas of study.
3. The stability and reputation of this master programme at Albanian University are consolidated in the higher education market in Albania. This gives this programme a competitive advantage against other programmes, mainly due to the fact that the programme is constantly being updated to maintain this competitive advantage.
4. The academic work practices give students the opportunity to explore and apply in practice what they have learned in this programme, expanding at the same time their network of relationships with real companies.
5. The assessment of active engagement in the classroom with 20% is a very positive factor because it guarantees not only the motivation and participation of students during the whole teaching process, but also gives lecturers an opportunity to introduce innovative teaching methods.

#### Weaknesses

1. The compatibility of academic staff, something also mentioned as a recommendation in the accreditation of 2018, evidenced through their degrees and in relationship to the modules they deliver could be better, justifying it not only through their work experience but also through their research work presented at conferences or published .

2. Limited capabilities of students with regards to scientific research methods and low involvement of the academic staff and students in research activities and publications, also mentioned among the recommendations of the previous accreditation for 2018.
3. Limited opportunities to be competitive on an International level as a result of limited use of materials and assessment methods in other languages (English) or of foreign literature more broadly among the teaching materials.
4. Lack of reports on the financial profitability and the plan for financial support related to the duration of this 2-year programme of study to guarantee the resilience of the programme based on the job market and demand.
5. Lack of a detailed budget-plan with specific items for supporting trainings and the criteria for funding related to research/scientific activities for the professional development of academic staff, as well as the absence of a transparent procedure for the allocation of research funds.
6. The library collection is limited in number and new entries.
7. High teaching load, whereby one PAE delivers 500 teaching contact hours per semester, something that might harm the quality of the programme and lead to lower participation in research-scientific activities.
8. Lack of specific criteria for the admission of students coming from other fields of study.

### Recommendations

1. The institution should consider the consistency between the academic profile of the staff involved and the subjects they cover.
2. The institution should increase the support for academic staff and students for their participation in international projects and research as well as for scientific publications in prestigious international journals with impact factor.
3. Reduce the teaching load, as another motivation for higher engagement in scientific research projects, or in new teaching methods. Motivate the academic staff with awards given periodically for achievements in innovative teaching methods based on an assessment made by the department and the students themselves.
4. Improve the international profile of the study program. Increase course requirements and make it possible to submit course assignments in English as well, initially as an elective option.
5. The institution should separate management and economics programs from applied sciences such as engineering and design in another faculty such as the Faculty of Social Sciences, or consider a better integration of management and economics with engineering and design.
6. Update the literature provided in the syllabi of this study program, with publications of the last five years.

### **Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	